

UDHËRRËFYES PËR PARLAMENTIN E HAPUR NË SHQIPËRI

(draft)

Tetor, 2024

TABELA E PËRMBAJTJES

1. HYRJE	3
2. MBI PARLAMENTIN E HAPUR NË SHQIPËRI	5
3. METODOLOGJIA.....	8
3.1 Kërkim dhe rishikimi i literaturës.....	8
3.2 Vlerësimi i treguesve për parlamentin e hapur	8
4. VLERËSIMI I NIVELIT TË “PARLAMENTIT TË HAPUR” NË SHQIPËRI- ANALIZË E THELLUAR	9
REFERENCA.....	52

1. HYRJE

Ky udhërrëfyes trajton konceptin e “parlamentit të hapur” dhe rëndësinë e tij në ndërtimin e një qeverisjeje të përgjegjshme, transparente dhe gjithëpërfshirëse në Shqipëri. Sipas **“Deklarata për Parlamentin e Hapur”¹ koncepti “parlamenti i hapur” nënkupton një institucion i cili është gjithëpërfshirës, transparent dhe i përgjegjshëm ndaj qytetarëve.² Ai nxit transparencën duke u siguruar që qytetarët të jenë të informuar për punën e tij, fuqizon pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në procesin legjislativ, dhe u jep qytetarëve mundësinë të mbajnë përgjegjës parlamentarët për veprimet e tyre.** Deklarata thekson se përmes një parlamenti të hapur, interesat e qytetarëve përfaqësohen më mirë dhe institucionet demokratike forcohen.³

Angazhimet për parlament të hapur po rriten me shpejtësi në kuadër të Partneritetit për Qeverisje të Hapur (OGP), ku shumë parlamente duke përfshirë edhe atë shqiptar po bashkëkrijojnë angazhimet ose planet e tyre të veprimit për të promovuar më tej hapjen legjislative. Një parlament i hapur përbën një pjesë thelbësore të një qeverisjeje të hapur.⁴

Matja dhe vlerësimi i parlamentit të hapur bëhet përmes disa treguesve kryesorë, të cilët sipas “Deklaratës për Parlamentin e Hapur” përfshijnë katër shtylla kryesore.⁵ Së pari, promovimi i një kulture të hapjes e cila nënkupton se informacioni parlamentar i përket publikut dhe duhet të jetë i aksesueshëm për të gjithë. Së dyti, bërja sa më transparente e informacionit që gjenerohet nga parlamenti, që do të thotë parlamenti duhet të ndjekë politika që sigurojnë transparencën e plotë përmes publikimit proaktiv të informacionit, duke i rishikuar ato rregullisht për të përfitur nga praktikat më të mira në zhvillim. Së treti, për të garantuar aksesin e gjerë, informacioni parlamentar duhet të jetë i disponueshëm për qytetarët në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese, përmes kanaleve të ndryshme, si vëzhgimi direkt në faqen e parlamentit, media e shkruar, radio dhe transmetimet live ose sipas kërkesës. Së katërti, ky informacion duhet të publikohet edhe në formate elektronike të hapura dhe të strukturuar, që u japin qytetarëve mundësinë ta analizojnë dhe ripërdorin me ndihmën e mjeteve teknologjike.⁶ Duke përdorur treguesit e secilit prej këtyre shtyllave, është bërë një vlerësim i nivelit të hapjes së parlamentit shqiptar.

Qëllimi i këtij udhërrëfyesi është të ofrojë një vlerësim të gjendjes aktuale të hapjes së parlamentit në Shqipëri dhe të sugjerojë hapa konkretë për përmirësimin e tij. Raporti synon të ndihmojë parlamentin shqiptar që të përmbushë standardet e një parlamenti të hapur, duke përforcuar transparencën, përgjegjshmërinë dhe përfshirjen qytetare në proceset legjislative.

Ky udhërrëfyes është strukturuar në katër kapituj kryesorë. Kapitulli i parë trajton përpjekjet që janë bërë nga aktorë të ndryshëm duke përfshirë edhe qeverinë, për të përmirësuar “hapjen” e parlamentit shqiptar. Kapitulli i dytë përshkruan hapat metodologjike që janë ndjekur për të punuar këtë udhërrëfyes. Kapitulli i tretë vjen me një vlerësim analitik të të

¹ Deklarata për Hapjen e Parlamenteve është një thirrje drejtuar parlamenteve kombëtare, si dhe institucioneve legjislative, e inicuar nga organizatat e shoqërisë civile që monitorojnë punën parlamentare, për të rritur angazhimin për transparencë dhe përfshirjen e qytetarëve në proceset parlamentare.

² Deklarata mbi Parlamentin e Hapur, <https://openingparliament.org/declaration/>.

³ Ibid.

⁴ <https://www.opengovpartnership.org/ep-content/uploads/2021/11/Open-Parliaments-Fact-Sheet.pdf>

⁵ Për Shqipërinë, organizatat e shoqërisë civile të cilat kanë marrë pjesë në zhvillimin ose kanë shprehur mbështetje për Deklaratën për Hapjen e Parlamenteve janë tre: Qendra e Studimeve Parlamentare, MJAFT dhe Koalicioni për Reforma, integrim dhe Institucione të Konsoliduara.

⁶ Katër shtyllat e parlamentit të hapur të përcaktuara në Deklaratën e Parlamentit të Hapur, <https://openingparliament.org/declaration/>.

gjitha treguesve të vlerësimit të parlamentit të hapur, duke ju referuar burimeve parësore dhe dytësore. Kapitulli i fundit ofron disa sugjerime për parlamentit shqiptar për përmirësimin e mëtejshëm të konceptit të “parlamentit të hapur”.

2. MBI PARLAMENTIN E HAPUR NË SHQIPËRI

Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të forcuar llogaridhënien dhe për të ndërtuar një parlament më transparent dhe pjesëmarrës, duke u mbështetur në praktikat më të mira ndërkombëtare. Megjithatë, përpjekjet për një “parlamenti të hapur” nuk duket të kenë dhënë rezultatet e pritshme. Iniciativat dhe përpjekjet parlamentare për të avancuar drejtë “hapjes” kanë qenë kryesisht të nxituara nga faktorët e jashtëm, në kuadër të përpjekjeve dhe projekteve të organizatave ndërkombëtare.

Një nga këto organizata ka qenë NDI. Në përpjekjet e vazhdueshme të NDI për të nxitur hapjen e parlamentit shqiptar, në vitin 2009 nisi një iniciativë rajonale për të zhvilluar aftësitë legislative, përfaqësuese dhe mbikëqyrëse të parlamenteve me financim nga “National Endowment for Democracy”.⁷ Duke përdorur përvojat nga parlamentet e Evropës Qendrore, kjo iniciativë trajton çështje të rëndësishme legislative në procesin e integritimit në BE. Fokusi është vënë te mbikëqyrja e buxhetit të shtetit, zhvillimi i stafit, operacionet e mbikëqyrjes së komisioneve dhe aplikimet e e-parlamentit. Në këtë drëjtim, NDI ka vijuar më tej me disa iniciativa të tjera të cilat kanë targetuar në mënyrë specifike parlamentin dhe orientimin e tij drejtë konceptit të “hapjes”.

NDI në bashkëpunim me Parlamentin e Shqipërisë kanë një rast studimor për të bërë një vlerësim gjithëpërfshirës për zhvillimin e parlamentit duke përdorur disa tregues për parlamentet demokratike. Indikatorët për Parlamente Demokratike janë një mjet gjithëpërfshirës për vetëvlerësim, të ndërtuar për të ndihmuar parlamentet të vlerësojnë kapacitetin dhe praktikën e tyre sipas standardeve demokratike. Ata janë të përshtatshëm për të gjitha parlamentet, pavarësisht sistemit politik apo fazës së zhvillimit. Të zhvilluar nga Unioni Ndër-Parlamentar (IPU), indikatorët përfshijnë 25 tregues, të grupuar në shtatë objektiva: efektivitet, llogaridhënie, transparencë, përgjegjshmëri, gjithëpërfshirje, pjesëmarrje dhe përfaqësim, duke ofruar kritere vlerësimi dhe rekomandime për përmirësim. Të gjithë këto tregues sinjalizojnë edhe për hapjen e parlamentit. Parlamenti i Shqipërisë përdori Indikatorët për Parlamente Demokratike si burim kryesor për zhvillimin e kuadrit të tij të standardeve. Në veçanti, parlamenti u bazua te indikatorët e Objektivit 3 (parlament transparent) dhe Objektivit 6 (parlament pjesëmarrës) për të kuptuar aspektet e ndryshme që e bëjnë parlamentin transparent dhe pjesëmarrës. Këto indikatorë gjithashtu u përdorën për të zgjidhur divergjencat në opinionin midis Parlamentit dhe aktorëve të tjerë të përfshirë.⁸ Pavarësisht mbështetjes së dhënë nga ana e Parlamentit, rezultatet e një matje të tillë pritet të vlerësohen. Në një anketim të realizuar nga IDM dhe NDI përgjatë vitit 2020, rezultoni që pjesa më e madhe e qytetarëve (54%) pranojnë se parlamenti nuk ka qenë i hapur ndaj qytetarëve për të marrë pjesë në komisionet parlamentare.⁹ Ky rezultat shënon për një aspekt të mungesës së hapjes parlamentare e parë në këndvështrimin qytetar.

“Hapja parlamentare” është vlerësuar duke ju referuar një serie treguesish të cilët janë pasuaruar më kalimin e kohës. Në raportin e titulluar “Analiza e hapjes parlamentare në Shqipëri dhe në rajon” përgatitur nga organizata MJAFIT për vitin 2019 i cili ishte i treti për nga natyra e tij i zhvilluar në Shqipëri dhe në rajon, jepet një pasqyrim të hapjes së parlamentit shqiptar dhe atyre në rajon, duke ndjekur një metodologji të përmirësuar mbështetur në një seri kriteresh të parlamentit të hapur. Sipas këtij raporti, duke ju referuar rezultateve të monitorimit të kryer nga dhjetori 2018 deri në shkurt 2019, Parlamenti shqiptar

7

<https://www.ndi.org/sites/default/files/Overview%20of%20Resources%20and%20Expertise%20available%20to%20Members%20of%20Parliament.pdf>

⁸ <https://kuvendi.eebfiles.blob.core.ëindoës.net/ëebfiles/DeklarateTransparence.pdf>

⁹ <https://www.ndi.org/sites/default/files/Albania%20Political%20Engagement%20Survey%202020%20English.pdf>

ka shënuar një performancë pozitive në 72.94% të treguesve të hapjes institucionale.¹⁰ Ky rezultat është 17.49% më i lartë se mesatarja e performancës së rajonit të Ballkanit Perëndimor, megjithatë ka pësuar një rënie të vogël krahasuar me vitin e kaluar. Sidoqoftë, Kuvendi mbetet institucioni publik me nivelin më të lartë të hapjes në nivel kombëtar. Sa i përket performancës administrative, katër shtyllat e qeverisjes së mirë për Parlamentin e Shqipërisë janë si më poshtë: 83.43% e treguesve të aksesueshmërisë, 78.52% e ndërgjegjësimit, 82.86% e integritetit dhe 62.21% e transparencës. Kuvendi ka shënuar rezultate më të ulta në transparencën lidhur me informacionin mbi buxhetin e shtetit, prokurimet publike dhe informacionin organizativ. Informacioni kryesor mbi aktivitetin e Kuvendit është publikuar në faqen zyrtare të institucionit, duke përfshirë kalendarin e tri javëve, agjendat e seancave plenare dhe rezultatet e votimeve të deputetëve.¹¹

Angazhimet për parlament të hapur po rriten me shpejtësi edhe në kuadër të Partneritetit për Qeverisje të Hapur (OGP), ku shumë parlamente duke përfshirë edhe atë shqiptar po bashkëkrijojnë angazhimet ose planet e tyre të veprimit për të promovuar më tej hapjen legjislative. Një parlament i hapur përbën një pjesë thelbësore të një qeverisjeje të hapur. Plani Kombëtar i Veprimit 2023-2025 për zbatimin e Partneritetit për Qeverisje të Hapur¹² synon të zhvillojë angazhime në tetë fusha ku njëra prej tyre është “parlamenti i hapur”.¹³

Më konkretisht, një nga masat e planifikuara në këtë drejtim është angazhimi 24 i titulluar “parlamenti i hapur dhe i aksesueshëm”. Angazhimi 24 synon koordinimin me Kuvendin për një Parlament të hapur dhe të aksesueshëm. Ky angazhim përfshin përmirësimin e platformës së mekanizmit ndërinstitucional për monitorimin e institucioneve të pavarura, si dhe zbatimin e sistemit të e-legjislacionit. Rezultatet e raportit të OGP për këtë periudhë nuk janë akoma publike por shënohet që në këtë drejtim janë arritur rezultate modeste.¹⁴

Përgjithësisht, planet për të nxitur parlamentin e hapur, kanë qenë në kuadër të projekteve të financuar nga organizata ndërkombëtare. Një nga këto është projekti “Për mbështetjen e Kuvendit dhe Edukimit Qytetar (PACEP)” në Shqipëri i cili synon të mbështesë Kuvendin për të përmirësuar performancën dhe profesionalizmin e administratës së tij, si dhe për të forcuar funksionet përfaqësuese, mbikëqyrëse dhe legjislative. PACEP financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i zbatuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe Instituti Demokratik Amerikan (NDI).¹⁵

Ky projekt është projektuar në dy faza. Aktualisht jemi në fazën e parë të zbatimit të tij 2018-2024¹⁶ ndërsa faza e dytë është projektuar për periudhën 2023-2028.¹⁷

Në rezultatet e parashikuara të fazës së parë të projektit ishin planifikuar:

¹⁰ https://www.mjft.org/sites/default/files/Parliament%20Openness_Albania.pdf

¹¹ Ibid.

¹² https://www.opengovpartnership.org/ep-content/uploads/2023/04/Albania_Action-Plan_2023-2025_EN.pdf

¹³ Fushat e tjera janë: anti-korrupsioni dhe pronarët përfitues, aksesin në drejtësi, transformimi dhe inovacioni digjital, transparenca fiskale, shërbimet publike, përfshirja, e drejta për informacion, konsultim dhe vlerësim të ndikimit rregullator.

¹⁴ https://www.opengovpartnership.org/ep-content/uploads/2024/02/Albania_Action-Plan-Review_2023-2025_EN.pdf

¹⁵ <https://www.eda.admin.ch/countries/albania/en/home/international-cooperation/projects.html/content/dezaprojects/SDC/en/2017/7F09576/phase1>

¹⁶ <https://www.eda.admin.ch/countries/albania/en/home/international-cooperation/projects.html/content/dezaprojects/SDC/en/2017/7F09576/phase1>

¹⁷ <https://www.eda.admin.ch/countries/albania/en/home/international-cooperation/projects.html/content/dezaprojects/SDC/en/2017/7F09576/phase2.html?oldPagePath=>

- Rezultat 1 – Administrata e Parlamentit përmbush funksionet e saj në mënyrë efikase dhe efektive.
- Rezultat 2 – Parlamenti përmirëson funksionet e tij legjislative, mbikëqyrëse dhe përfaqësuese duke përfaqësuar më mirë qytetarët dhe duke mbajtur degën ekzekutive të përgjegjshme.
- Rezultat 3 – Qytetarët kërkojnë hapësirën e tyre në zhvillimet demokratike të vendit dhe janë të përgatitur të mbajnë përgjegjësi deputetët dhe të ndikojnë në reformat.

Të tre këto rezultate të parashikuara, janë pjesë thelbësore e vlerësimit të parlamentit të hapur por më konkretisht një nga aspektet që shënohet është zbatimi i e-legjislacionit duke duke aplikuar standardin “AKN4AL” për dokumentet parlamentare dhe normative.

3. METODOLOGJIA

Ky udhërrëfyes është ndërtuar duke u mbështetur në kërkimin e thelluar të literaturës, evidencave, raporteve dhe ligjeve si dhe në të dhëna parësore të siguruar nga intervista të thelluara.

3.1 Kërkim dhe rishikimi i literaturës

Grupi i punës ka zhvilluar një kërkim të thelluar të literaturës duke përfshirë një gamë të gjerë burimesh të informacionit. Kërkimi është kryer nëpërmjet një përdorimi të kujdesshëm të raporteve të organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare, materialeve akademike, dokumenteve strategjike dhe dokumenteve të tjera të konsultuara. Lista e plotë e burimeve gjendet në seksionin e referencave.

3.2 Vlerësimi i treguesve për parlamentin e hapur

Në ndërtimin e matricës së vlerësimit për situatën aktuale të hapjes së parlamentit, është përdorur lista e treguesve të ndërtuar në dokumentin e “Deklaratës për Hapjen e Parlamentit” i cili mbështetet në katër shtylla kryesore.

Shtylla e parë është “Promovimi i një kulture të hapjes” e cila vlerësohet nëpërmjet 12 treguesve. Shtylla e dytë është “Bërja sa më transparente e informacionit të parlamentit” e cila vlerësohet nëpërmjet 14 treguesve. Shtylla e tretë është “Lehtësimi i aksesit në informacionin parlamentar” e cila vlerësohet nëpërmjet 8 treguesve. Shtylla e katërt “Mundësimi i komunikimit elektronik të informacionit parlamentar” e cila vlerësohet nëpërmjet 10 treguesve. Në kuadër të ndërtimit të këtij udhërrëfyesi, secili prej këtyre indikatorëve është vlerësuar duke u mbështetur nga evidenca të cilat janë të publikuara apo dhe nga të dhëna të cilat janë siguruar nëpërmjet burimeve parësore.

4. VLERËSIMI I NIVELIT TË “PARLAMENTIT TË HAPUR” NË SHQIPËRI- ANALIZË E THELLUAR

Deklarata për Parlamentin e Hapur¹⁸ paraqit katër shtylla kryesore për arritjen e transparencës parlamentare. Cdo shtyllë ka kriteret e saj të cilat duhet të ndiqen nga parlamentet sa më mirë të jetë e mundur në mënyrë që të arrihet qëllimi i “parlamentit të hapur.”

Shtylla 1: PROMOVIMI I NJË KULTURE TRANSPARENCE

Kriteri 1: *Njohja e të drejtës publike mbi informacionin parlamentar.*

Informacioni parlamentar i përket publikut. Qytetarët duhet të lejohen të ripërdorin dhe ribotojnë informacionin parlamentar, në tërësi ose pjesërisht. Çdo përjashtim ose kufizim nga ky parim duhet të përcaktohet me saktësi në mënyrë të detajuar nga ligji.

Kriteri 2: *Përparimi i kulturës së transparencës nëpërmjet legjislacionit .*

Parlamenti ka detyrimin të miratojë legjislacion, si edhe rregulla të brendshme procedurale dhe kode të sjelljes që t'i garantojë publikut akses në informacionin parlamentar.

Kriteri 3: *Mbrojtja e një kulture transparence nëpërmjet mbikqyrjes.*

Në përmbushjen e funksionit të tij të mbikqyrjes, parlamenti do të garantojë që ligjet që sigurojnë transparencën e qeverisë të zbatohen në mënyrë efektive, që qeveria të veprojë në një mënyrë plotësisht transparente.

Në Shqipëri ka disa kufizime për sa i përket aksesit mbi disa dokumenta sensitive të cilat lidhen me sigurinë kombëtare, privatësinë ose informacionin konfidencial. Por, pavarësisht se kjo mund të shkaktojë kufizime në aksesimin e informacionit, ligji i përcakton qartë këto kufizime, specifikisht ligji mbi të drejtën e informimit¹⁹, ndaj është në përputhje me Kriterin 1 . Megjithëse informacioni, përveç informacioneve konfidenciale të lartpërmendura, është i disponueshëm, formati në të cilin ofrohet mund të kufizojë ripërdorimin. Për shembull, disa dokumente janë në formate PDF, të cilat nuk lexohen automatikisht nga makineritë duke e bërë të vështirë ripërdorimin.

Ekzistojnë rregullime ligjore të cilat synojnë të lehtësojnë angazhimin e publikut në procesin legjislativ si edhe synojnë të krijojnë një raport transparent midis publikut dhe parlamentit, si për shembull Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik²⁰, i cili është një instrument kyç për promovimin e transparencës parlamentare dhe angazhimit të publikut dhe në përputhje me Kriterin 2 ,ose ligji për të drejtën e informimit²¹ në përputhje me Kriterin 3.

Shqipëria gjithashtu është angazhuar në marrëveshje rajonale dhe ndërkombëtare për të rritur transparencën e parlamentit, si për shembull Partneriteti për qeverisje të hapur

¹⁸ Deklarata për Hapjen e Parlamenteve është një thirrje drejtuar parlamenteve kombëtare, si dhe institucioneve legjislative, e inicuar nga organizatat e shoqërisë civile që monitorojnë punën parlamentare, për të rritur angazhimin për transparencë dhe përfshirjen e qytetarëve në proceset parlamentare.

¹⁹ Ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar;

²⁰ Ligji 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”;

²¹ Ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar;

(PQH)²². Gjithashtu, raportet parlamentare dhe progresi në lidhje me këto angazhime tregojnë përmthshmëri me normal globale për parlamentin e hapur.

Por pavarësisht prezencës së këtyre kuadreve ligjore për të arritur transparencën parlamentare, shpesh ka një neglizhencë nga autoritetet publike për tu konsultuar me publikun. Ky fakt mund të shkaktojë një ulje në cilësinë e ligjeve dhe politikave si edhe të ulë besimin e publikut për sa i përket ndikimit që kanë në procesin legjislativ. Studime të ndryshme^{23/24} tregojnë se ka një mungesë mekanizmash për të marrë mendimet e publikut mbi legjislaturën dhe punën e parlamentit në tërësi. Këto studime, specifiku Raporti nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, na njohin me një gjykim se bashkëpunimi midis parlamentit dhe publikut është sipërfaqësor dhe i pamjaftueshëm.²⁵ Ndaj, një sugjerim për të qenë sa më afër përmbushjes së këtij kriteri do të ishte krijimi i një sistemi “feed-back” ku qytetarët të mund të jepnin mendimet e tyre mbi aktivitetin e parlamentit dhe të krijohej një marrëdhënie më proaktive.

Gjithashtu, transparenca nuk është gjithmonë në nivelin e kërkuar nga këto kritere, si për shembull, zbatimi i ligjit për të drejtën e informimit është shpesh herë i cunguar. Ekzistojnë mungesa dhe vonesa në informacion. BIRN Albania²⁶ dhe AIS²⁷ kanë raportuar se shumë institucione publike në Shqipëri nuk kanë dhënë përgjigje për kërkesat e paraqitura në bazë të ligjit për të drejtën e informimit.

Kriteri 4: Promovimi i edukimit të qytetarëve.

Parlamenti ka përgjegjësinë të promovojë aktivisht edukimin e qytetarëve, mbi kuptimin e rregullave dhe procedurave, punës dhe procedurave të parlamentit dhe antëraëve të tij. Në kuadër të projektit PACEP, janë duke u bërë përpjekje për të rritur ndërgjegjësim dhe edukimin qytetar. Megjithatë, rezultatet konkrete akoma nuk janë të dukshme në këtë drejtim.

Kriteri 5: Angazhimi u qytetarëve dhe shoqërisë civile.

Parlamenti ka detyrim të angazhojë aktivisht shoqërinë civile, pa diskriminim, në proceset dhe vendimmarrjet parlamentare. Kjo bëhet në mënyrë që interesat e qytetarëve të bëhen në mënyrë efektive dhe për t'i dhënë qytetarëve të drejtën për të bërë kërkesa ndaj qeverisë tyre.

Parlamenti Shqiptar është munduar të rrisë edukimin e qytetarëve mbi informacionin parlamentar. Disa shembuj që e tregojnë këtë janë, ditët e hapura që organizon parlamenti për studentët, faja web e kuvendit²⁸, shpërndarja e broshurave me informacione të ndryshme. Kjo është një tentativë e mirë për t'iu afruar përmbushjes së kriterit 4.

Gjithashtu ka iniciativa për të rritur angazhimin e publikut, si për shembull dëgjuesat publike dhe konsultimet online, për të cilat ka edhe një faqe zyrtare web. Këto iniciativa janë në përputhje me Kriterin 5²⁹.

²² <https://ogp.gov.al/faqe/cfare-eshte>

²³ <https://idmalbania.org/report-cso-participation-in-decision-making-in-albania/>

“Pjesëmarrja e shoqërisë civile në vendimmarrje në Shqipëri”

²⁴ <https://idmalbania.org/research-report-a-decade-of-public-consultation-laë-in-albania-call-for-reform/> “Një dekadë e ligjit të konsultimeve publike në Shqipëri: Thirrja për reformë

²⁵ ibid

²⁶ <https://birn.eu.com/netëork/birn-albania/>

²⁷ <https://ais.al/new/>

²⁸ <https://www.parlament.al>

²⁹ <https://www.konsultimipublik.gov.al>

Megjithatë, ka shumë vend për përmirësim³⁰. Si për shembull mund të ketë më shumë programe edukative, veçanërisht për rininë, si vizitat e shkollave në Parlament. Pavarësisht se këto vizita bëhen, shpeshësia e tyre është sporadike dhe nuk merr parasysh shkolla të zonave rurale. Në këto zona aksesit në këto iniciativa është shumë i kufizuar, duke i lënë qytetarët të painformuar. Duhet shtuar se ka gjithashtu një mungesë promovimi për aktivitetet informuese, që shkakton që qytetarët mos të kenë dijeni për këto programe duke shkaktuar përsëri një mungesë informimi.

Për ato programe informimi të cilat ndodhin, nuk ka një mënyrë standarde monitorimi për sa i përket efikasitetit dhe cilësisë së programit. Duhet të krijohet një sistem monitorimi në mënyrë që qytetarët të shprehin pakënaqitë e veta si edhe të bëjnë sugjerime mbi përmirësimin e programeve, diçka kjo e cila ndihmon edhe parlamentin edhe publikun.

Për sa i përket iniciativave për angazhimin e qytetarëve në lidhje me kriterin 5, ka ende shumë mungesa. Shqetësimi kryesor është në lidhje me efikasitetin dhe transparencën e këtyre iniciativave.

Procesi parlamentar në Shqipëri përballet me pengesa për të siguruar që të gjitha demografitë, pa marrë parasysh gjininë, etninë, moshën ose aftësinë, të jenë aktivisht të angazhuara. Raportet sugjerojnë se, ndërsa disa përpjekje bëhen për të përfshirë grupet e marginalizuara, si personat me aftësi të kufizuara, këto iniciativa ndoshta nuk janë të mjaftueshme për të garantuar pjesëmarrjen e tyre efektive në vendimmarrje.³¹

Parlamenti Evropian dhe organe të tjera ndërkombëtare theksojnë nevojën për parlamentet që jo vetëm të ofrojnë informacion, por të krijojnë mundësi për kontributin e publikut në procesin legjislativ. Kjo përfshin platforma për feedback qytetar, si peticionet elektronike dhe diskutimet publike.

Praktikat aktuale të Shqipërisë duhet të përputhen më afër me këto standarde për të përmirësuar ndjeshëm angazhimin e qytetarëve, pasi në këtë moment gjykimi është se nuk ka asnjë përmirësim.³²

Kriteri 6: Mbrojtja e një shoqërie civile të pavarur.

Parlamenti ka detyrimin të mbështesë masat për të siguruar që organizatat e shoqërisë civile të jenë në gjendje të operojnë lirisht dhe pa kufizime.

Kuadri ligjor shqiptar mbetet një mjet shumë i rëndësishëm për arritjen e këtij kriteri. Ligjet e lartpërmendura, dëgjesat dhe konsultimet janë disa mënyra të mira që parlamenti të arrijë këto kritere.

Sipas ligjeve ndërkombëtare siç janë Deklarata Universale e të drejtave të Njeriut³³ dhe Marrëveshja Ndërkombëtare për të drejtat Civile dhe Politike,³⁴ shtetet kanë obligimin të mbrojnë të drejtat e organizatave civile. Organizatat në Shqipëri shpesh hasin pengesa në funksionimin e tyre për shkak të mungesës së mbështetjes nga institucionet shtetërore dhe frikësimit të mundshëm nga ndrydhja politike ose institucionale që mund të hasin.

³⁰ <https://www.eda.admin.ch/countries/albania/en/home/international-cooperation/projects.html/content/dezaprojects/SDC/en/2017/7F09576/phase1>

³¹ <https://www.partnersalbania.org/publication/participation-of-civil-society-and-citizens-in-decision-making/>

³² <https://citizens.al/en/2024/04/11/the-report-of-freedom-house-democracy-in-Albania-no-improvement/>

³³ <https://www.un.org/en/about-us/universal-declaration-of-human-rights>

³⁴ <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/international-covenant-civil-and-political-rights>

Kriteri 7: Mundësimi i monitorimit efektiv të Parlamentit.

Parlamenti duhet të njohë të drejtën dhe detyrën e shoqërisë civile, medias dhe publikut për të mbikëqyrur parlamentin dhe anëtarët e tij. Parlamenti duhet të angazhohet në konsultime me publikun dhe organizatat e shoqërisë civile që mbikëqyrin parlamentin për të reduktuar pengesat në aksesimin e informacionit.

Parlamenti shqiptar ka angazhuar nisma për të rritur pjesëmarrjen publike. Këto nisma përfshijnë konsultime publike mbi projektligje dhe bashkëpunime me OSHC për të promovuar dialogun ndërmjet qytetarëve dhe parlamentarëve. Sidoqoftë mbeten sfida në lidhje me nivelin e përfshirjes publike, si u përmenden dhe më lartë.

Kriteri 8: Shpërndarja e praktikave të mira.

Parlamenti duhet të marrë pjesë aktivisht në shkëmbime ndërkombëtare dhe rajonale të praktikave të mira, me parlamente të tjera dhe me organizatat e shoqërisë civile për të rritur transparencën, për të përmirësuar përdorimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit dhe për përmbushjen e parimeve demokratike.

Shqipëria ka marrë pjesë në disa organizata ndërkombëtare që promovojnë transparencën dhe përmirësimin e qeverisjes, siç është Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës dhe IPU (Unioni Ndërkombëtar i Parlamentarëve). Këto platforma ofrojnë mundësi për shkëmbimin e praktikave të mira.

Por, pjesëmarrja e Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare është shpesh e kufizuar. Ndërsa anëtarësimi ekziston, angazhimi aktiv dhe kontributet në diskutime janë minimale, sipas raportit të Mjaft.³⁵ Keshtuqë, një sugjerim është që Parlamenti Shqiptar të synojë të rrisë angazhimin në këto organizata në mënyrë që të përditësojë praktikën që ndjek për sa i përket transparencës.

Kriteri 9: Sigurimi i burimeve ligjore.

Parlamenti duhet të miratojë legjislacion për të siguruar që qytetarët kanë akses efektiv në mjete ligjore ose gjyqësore për informacione parlamentare.

Kriteri 10: Shpërndarja e informacionit të plotë.

Informacioni parlamentar i disponueshëm për publikun duhet të jetë sa më i plotë të jetë e mundur, duke reflektuar tërësinë e veprimeve parlamentare, me përjashtim të rasteve të përcaktuara me detaje nga ligji.

Kriteri 11: Mundësimi i informacionit në kohë.

Informacioni parlamentar duhet t'i ofrohet publikut në një kohë të duhur. Si rregull i përgjithshëm informacioni duhet të ofrohet në kohë reale. Në rastet kur kjo nuk është e mundur, duhet të ofrohet sa më shpejtë të jetë e mundur.

Kriteri 12: Sigurimi i informacionit të saktë.

Parlamenti do të sigurojë një proces për të ruajtur regjistrat autoritarë dhe për të garantuar që informacioni që publikon për publikun të jetë i saktë.

Ligji për të drejtën e informimit³⁶ mbetet një nga instrumentet më të rëndësishme për të siguruar që qytetarët të marrin informacionin që kërkojnë. Ky ligj është në përputhje me të

³⁵ [https://www.mjaft.org/en/reports/report-albanian-parliament-openness;](https://www.mjaft.org/en/reports/report-albanian-parliament-openness)

³⁶ Ligji 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar;

gjitha kriteret nga 9 tek 12. Ligjet dhe rregulloret aktuale për transparencën kërkojnë që Parlamenti të publikojë informacione mbi ligjet, seancat plenare, komisionet, si edhe dokumentet shoqëruese. Raportet parlamentare dhe dokumentet e komisioneve bëhen publike sipas rregullores së brendshme të Kuvendit³⁷ dhe praktikave të vendosura për transparencë. Në përgjithësi këto dokumente mund të gjenden në faqjen zyrtare të Parlamentit dhe bëhen publike pas miratimit në komisione ose seanca plenare. Përmes këtyre praktikave Parlamenti i Shqipërisë synon që informacioni i shpërndarë të jetë i saktë dhe i plotë.

Sidoqoftë ka vend për përmirësim për sa i përket standardit të krijuar nga këto kritere (9,10,11,12).

Sipas raportit të MJAFIT³⁸, Shqipëria plotëson vetëm 60% të këtyre kritereve të transparencës parlamentare. Ky raport, vlen të përmedet se është i vjetër në datë publikimi, por ka prova që vërtetojnë se mbetet i saktë, si për shembull raporti i cituar më sipërm i publikuar në 2024 ku thuhet se nuk ka asnjë përmirësim në lidhje me praktikën e transparencës.³⁹

Për sa i përket mundësisimit të informacionit të plotë dhe në kohë, ky proces është shpesh i kufizuar nga mungesa e përditësimeve të rregullta dhe aksesit të plotë në të gjitha materialet e përshtatshme. Sipas një raporti të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)⁴⁰, në Shqipëri, publikimi i dokumenteve është shpesh i fragmentuar, duke qenë në mungesë të dokumenteve mbështetëse, të cilat janë thelbësore për të kuptuar kuadrin e plotë të veprimtarive ligjore të Kuvendit. Për shembull, shpesh mungojnë raportet e komisioneve dhe ndryshimet e propozuar.

Në shumë raste publikimi i dokumenteve në Shqipëri nga Parlamenti, ndodh mbas disa ditësh. Raporti i World e-Parliament⁴¹ sugjeron që dokumentet të bëhen publike brenda 24 orëve pas përgatitjes. Në Shqipëri mungon një rregullim i qartë ligjor për publikimin e agjendave dhe dokumenteve të komisioneve brenda afateve të caktuara. Vende si psh. Greqia dhe India i bëjnë këto dokumente të disponueshme për publikun brenda 24 orëve.

Nëse përqendrohemi në kriterin që informacioni parlamentar duhet të jetë i saktë, në nivel ndërkombëtar, praktikën për të garantuar saktësinë përfshijnë përdorimin e standardeve të hapura për dokumentet, si edhe sistemet e shënimit (markup) të bazuara në XML për të minimizuar gabimet njerëzore dhe për të përmirësuar saktësinë në përpunimin dhe publikimin e dokumenteve legjislative. Parlamenti Evropian përdor pikërisht këtë teknologji për të siguruar përmbushjen e këtij kriteri. Shqipëria ka treguar interes për adaptimin e teknologjive të reja por nuk ka asnjë provë që një sistem i tillë të ketë nisur përdorimin në Shqipëri.

SHTYLLA 2: TË ARRIHET INFORMACIONI PARLAMENTAR TRANSPARENT

Kriteri 13: *Miratimi i politikave për transparencën parlamentare.*

Parlamenti do të miratojë politika që sigurojnë shpërndarjen proaktive të informacionit parlamentar, duke përfshirë politikat në lidhje me formatet në të cilat ky informacion do të publikohet. Politikën e transparencës do të specifikojnë kushtet për rishikimin e tyre periodik për të shrytëzuar zhvillimet teknologjike dhe praktikave të mira. Kur parlamenti nuk ka

³⁷ <https://www.parlament.al/Kuvendi/Rregullorja>

³⁸ <https://www.mjaft.org/en/reports/report-albanian-parliament-openness>

³⁹ <https://citizens.al/en/2024/04/11/the-report-of-freedom-house-democracy-in-Albania-no-improvement/>

⁴⁰ <https://idmalbania.org/research-report-a-decade-of-public-consultation-laë-in-albania-call-for-reform/>

⁴¹ <https://www.ipu.org/resources/publications/reports/2016-07/eorid-e-parliament-report-2010>

mundësi të publikojë menjëherë informacionin duhet të krijojë parteritete me shoqërinë civile për të siguruar akses të gjërë publik në informacionin parlamentar.

Ligji për të drejtën e informimit siguron aksesin publik në dokumentet parlamentare. Krijimi i Avokatit të Popullit për të trajtuar çështjet e aksesit në informacion, është një përmirësim për të arritur përputhjen me standardet e transparencës.

Mungon një strategji e qartë që të përfshijë rishikime periodike të politikave të transparencës, si ndodh në vende si Kanadaja dhe Bretëria e Bashkuar.

Kriteri 14: *Mundësimi i informacionit mbi rolet dhe funksionet e Parlamentit.*

Parlamenti duhet të bëjë të disponueshëm informacionin mbi rolin e tij kushtetues, strukturën, funksionet.

Kriteri 15: *Mundësimi i informacionit mbi anëtarët e Parlamentit.*

Parlamenti do të ofrojë informacion te mjaftueshëm dhe të përditësuar rregullisht për qytetarët për të kuptuar akredimiet e një anëtarim lidhjen me partinë, mandatin zgjedhor, rolet në parlament, frekuentimin, identitetet e stafit personal. Informacioni i kontaktit të punës për zyrat parlamentare dhe ato të njësisve zgjedhore të anëtarëve duhet gjithashtu të jenë të disponueshme.

Kriteri 16: *Mundësimi i informacionit mbi stafin dhe administratën parlamentare.*

Parlamenti do të bëjë të disponueshëm informacionin mbi funksionin e tij administrativ dhe strukturën e stafit parlamentar që menaxhon dhe administron proceset parlamentare. Ky informacion duhet të jetë publikisht i disponueshëm.

Ka disa përpjekje të Parlamentit Shqiptar për të ofruar informacion mbi roles dhe funksionet e tij, si për shembull Neni 22 i Kushtetues bën të qartë të drejtën e shoqërisë civile për të patur informacione publike, dhefaqja e Parlamentit ofron informacion mbi rolet e Parlamentit si edhe mbi anëtarët, përfhirë emrat, përfaqësimin partiak dhe komisionet në të cilat shërbejnë.

Sidoqoftë mangësitë janë të shumta. Duhet të ketë përmirësim në pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset legjislativë përmes burimeve edukative dhe mjeteve interaktive. Kjo përfshin video edukative dhe burime të tjera interaktive, ashtu siç janë zbatuar në vende si Mbretëria e Bashkuar.

Gjithashtu informacioni mund të jetë më i detajuar dhe i aksesueshëm për qytetarët. Informacione më të detajuara për mandatin zgjedhor, përvoja profesionale, dhe historina e karrierës së anëtarëve shpesh mungojnë osë janë të limituara. Në disa raste, informacioni mbi stafin personal dhe rolet e tyre jashtë Parlamentit është i papërfshirë. Sipas udhëzimeve të IPU,⁴² shumë parlamente në botë ofrojnë informacione të detajuara për anëtarët e tyre, duke përfshirë biodata, foto, informacione për komisionet dhe aktivitetet parlamentare. Për shembull, Parlamenti i Afrikës së Jugut ka një sistem të mirë të organizuar për të ofruar këtë informacion. Një sugjerim është që Parlamenti Shqiptar të adoptojë praktikatat me të mira ndërkombëtare duke krijuar një platformë online ku çdo anëtar të ketë një faqe personale me informacion të detajuar mbi karrierën e tij, aktivitetet legjislativë, dhe mënyrat e kontaktit me qytetarët. Kjo do të ndihmonte rritjen e angazhimit të qytetarëve dhe besimit në institucionet parlamentare.

⁴² <https://www.ipu.org/>

Sipas praktikave të mira, informacioni i kontaktit për anëtarët duhet të jetë gjithmonë i disponueshëm për publikun, por në Shqipëri kjo nuk është standardizuar duke i lënë qytetarët pa një mënyrë akses të qartë.

Kriteri 17: Mundësimi i informacionit mbi Agjendën Parlamentare.

Dokumentacioni në lidhje me planifikimin e punëve parlamentare do të ofrohet për publikun, duke përfshirë kalendarin e seancave, informacionin mbi votimet e planifikuara, rendin e punës dhe orarin e dgjësave dhe komisioneve. Përveç rasteve të rralla që lidhen me legjislacionin urgjent, parlamenti do të ofrojë njoftim të mjaftueshëm përpara për të lejuar publikun të japin sugjerime dhe kontribut.

Parlamenti Shqiptar ka përmirësuar praktikën e tij në publikimin e kalendarëve të punës dhe rendit të ditës për seancat e tij. Sipas informacionit nga faqja zyrtare e Parlamentit, informacioni rreth seancave të planifikuara, votimeve dhe komisioneve shpallet në mënyrë të rregullt, duke lejuar kështu që qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile të angazhohen më lehtë në proceset legjislative.

Por, shpesh ndodhin vonesa në publikimin e agjendës, duke penguar mundësinë për një angazhim të plotë nga ana e qytetarëve. Organizata ndërkombëtare si Komisioni Evropian dhe OECD kanë dhënë rekomandime për përmirësimin e transparencës dhe angazhimit të qytetarëve në proceset legjislative në Shqipëri. Sipas raportit Botëror për Parlamentin Digjital 2010⁴³, 85% e faqeve parlamentare publikojnë orare të përditshme, me 70% që ofrojnë kalendarin e seancave plenare të paktën dy ditë para takimeve. Këto rekomandime përfshijnë rritjen e aksesit në informacion dhe përmirësimin e komunikimit midis parlamenteve dhe qytetarëve.

Kriteri 18: Angazhimi i qytetarëve në hartime ligjesh.

Legjislacioni i hartuar do të bëhet publik që në prezantimin e tij. Duke njohur nevojën që qytetarët të jenë plotësisht të informuar dhe të japin kontribut për çështjet që janë në shqyrtim, parlamenti do të përpiqet të sigurojë akses publik në analizat përgatitore dhe informacionin e prapavijës për të inkurajuar një kuptim të gjerë të diskutimeve mbi politikatat në lidhje me legjislacionin e propozuar.

Hartimi i legjislacionit në përgjithësi bëhet publik në momentin e prezantimit të tij. Kuvendi i Shqipërisë ka një faqe zyrtare ku publikohen dokumentet legjislative, duke përfshirë ligjet e propozuara, ndryshimet dhe raportet. Kuvendi ka bërë disa hapa përpara në ofrimin e aksesit të informacionit legjislativ. Për shembull platforma, e-albania, lejon qytetarët të shohin dokumente të ndryshme qeveritare, duke përfshirë hartimet/draftet e ligjeve. Kuvendi ka nisur konsultime publike për disa projektligje.

Ndërsa ligji kërkon që dokumentet të jenë të aksesueshme, ka shqetësime në lidhje me shkallën e vetëdijes dhe kuptimit të publikut për këto dokumente. Niveli i detajeve dhe analizës ofruar bashkë me këto dokumente duhet të përmirësohet. Raportet ⁴⁴tregojnë se ndërsa organizatat e shoqërisë civile shpesh marrin pjesë në këto diskutime, shkalla e ndikimit të tyre në rezultatet përfundimtare mund të jetë e kufizuar. Madje shumë qytetarë mund mos të kenë dijeni për kalendarin legjislativ, faktor i cili rrjedh si pasojë e mungesës së promovimit.

Kriteri 19: Publikimi i regjistrave të seancave të komisionit.

⁴³ <https://publicadministration.desa.un.org/publications/ëorld-e-parliament-report-2010>

⁴⁴ <https://www.mjft.org/en/reports/report-albanian-parliament-openness>

Raportet e procedurave të komisioneve, duke përfshirë dokumentet e krijuara dhe të pranuar, dëshmitë e dëshmitarëve në dëgjesat publike, transkriptet dhe regjistrat e veprimeve të komisioneve, duhet të bëhen publike shpejtë.

Legjislacioni shqiptar parashikon që raportet e procedurave të komisioneve, përfshirë dokumentet e krijuara dhe të pranuar, dëshmitë e dëshmitarëve nga dëgjesat publike dhe regjistrat e veprimeve të komisioneve, duhen bërë publike menjëherë.

Ligji e lejon që dëgjesat dhe takimet e komisioneve të jenë të hapura për publikun në mënyrë që qytetarët të kenë akses në informacionin mbi vendimet legjislative.

Shpesh ka vonesa në publikimin e këtyre informacioneve dhe pavarësisht se ligji e lejon dhe e kërkon transparencën e dëgjesave dhe takimeve të komisioneve, zbatimi i tij është i papërsosur.

Kriteri 20: Regjistrimi i votave parlamentare.

Për të siguruar përgjegjësinë e anëtarëve ndaj elektoratit për sjelljen e tyre në votim, parlamenti do të minimizojë përdorimin e votimit me zë në seanca plenare dhe do të përdorë votimin me thirrje emri ose votimin elektronik në shumicën e rasteve, duke bërë të disponueshëm për publikun një regjistër të sjelljes së votimit të anëtarëve. Po ashtu parlamenti do të minimizojë votimin me madat dhe do të sigurojë që kjo mos të ulë transparencën parlamentare dhe përgjegjësinë demokratike.

Në Shqipëri, votimi elektronik përdoret shpesh në seancat plenare dhe rezultatet e votimit më pas publikohen në faqjen e parlamentit. Kjo ofron një farë transparence për sa i përket sjelljes së deputetëve.

Megjithatë, diskutimet në komisionet parlamentare shpesh mbahen me dyer të mbyllura, duke limituar aksesin e drejtpërdrejtë nga publiku në procesin e votimit të komisioneve. Një aspekt që kërkon përmirësim që kërkon përmirësim është minimizimi i përdorimit të votimit me zë dhe zbatimi më i gjerë i votimit elektronik ose me thirrje emrash, që siguron se votja e secilit deputet regjistrohet dhe bëhet publike.

Kriteri 21: Publikimi i regjistrave të seancave plenare.

Parlamenti duhet të krijojë, mbajë dhe publikojë regjistrat të lehtë për tu aksesuar të procedurave të tij plenare, idealisht në formën e regjistrimeve audio ose video, të mbajtura online në një vend të përshershëm, si edhe në formën e një transkripti të shkruar.

Në Shqipëri seancat plenare transmetohen drejtpërdrejt dhe janë të regjistruara, duke iu ofruar qytetarëve mundësinë të ndjekin aktivitetet parlamentare nëpërmjet kanaleve mediatike dhe internetit. Faqja zyrtare e Kuvendit të Shqipërisë përfshin rendin e ditës, dokumentet e depozituara dhe regjistrimet e seancave, duke përmbushur këtë kriter.

Përmirësimi që mund të sugjerohet është forcimi i mëtejshëm i publikimit të transkripteve të shkruara të debateve parlamentare, të cilat në shumë raste nuk janë të aksesueshme nga publiku.

Kriteri 22: Publikimi i raporteve të krijuara prej ose për Parlamentin.

Të gjitha raportet do të bëhen publike tërësisht përveç rasteve të përcaktuara me ligj.

Me miratimin e ligjit Nr. 146/2014 për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, synohej forcimi i hapjes institucionale. Ky ligj kërkon që procoesi legjislativ të jetë i hapur dhe të përfshijë qytetarët dhe organizatat jofitimprurëse në vendimarrje.

Një aspekt kritik për Shqipërinë është nevoja për të përfshirë të dhëna të plota dhe në formate të hapura në raportet e dorëzuara nga Parlamenti. Kjo mungesë nuk lejon analizën dhe përdorimin e informacionet nga palët e treta, duke siguruar integritetin dhe cilësinë e vendimeve politike të marra mbi bazën e atij informacioni. Ka probleme në tërësi me implementimin e plotë të këtij ligji.

Kriteri 23: *Mundësimi informacionit mbi buxhetin dhe shpenzimet.*

Parlamenti ka përgjegjësinë të bëjë publik informacion të plotë, të detajuar dhe lehtësisht të kuptueshëm rreth buxhetit kombëtar dhe shpenzimeve publike, duke përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet e kaluara, aktuale dhe të parashikuara. Po ashtu, parlamenti ka detyrën të publikojë informacion rreth buxhetit të vet, duke përfshirë informacion mbi ekzekutimin e tij të buxhetit dhe ofertat e kontratat. Ky informacion do të bëhet publik në tërësi, duke përdorur një taksonomi konsistente, së bashku me përmbledhje, shpjegime ose raporte në një gjuhë të thjeshtë që ndihmojnë në promovimin e kuptimit të qytetarëve.

Kriteri 24: *Deklarimi i pasurive dhe garantimi i integritetit të anëtarëve.*

Parlamenti do të bëjë të disponueshëm informacion të mjaftueshëm për të lejuar qytetarët të formojnë gjykime të informuara në lidhje me integritetin dhe ndershmërinë e anëtarëve, duke përfshirë informacion mbi deklaratat e pasurisë të anëtarëve, shpenzimet e tyre parlamentare dhe të ardhurat e tyre jo-parlamentare, duke përfshirë interesa, dividende, pagesa qiraje ose përfitime të tjera në natyrë.

Shqipëria ka ndërmarrë disa hapa për sa i përket transparencës buxhetore dhe publikimit të shpenzimeve publike. Ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin⁴⁵ dhe ligji për auditimin e brendshëm⁴⁶, synojnë të sigurojnë transparencën e buxhetit kombëtar. Kuadri ligjor gjithashtu kërkon që zyrtarët publikë, përfshirë deputetët, të deklarojnë pasuritë e tyre financiare, interesat tregtare dhe çdo konflikt të mundshëm interesi, në përputhje me standardet ndërkombëtare për transparencë.

Sfidat mbeten në mungesën e zbatimit të plotë të tyre. Institucionet publike shqiptare publikojnë të dhëna buxhetore dhe të shpenzimeve, përfshirë buxhetin e tyre vjetor dhe raportet financiare. Niveli i detajimit dhe qartësisë së informacionit për qytetarët mbetet i kufizuar. Platforma si Open Data Albania⁴⁷ dhe Ministria e Financave publikojnë të dhëna në formate të hapura, por shpesh herë mungon një përmbledhje e thjeshtuar që qytetarët ta kuptojnë lehtësisht informacionin mbi të shpenzimet publike dhe alokimin e fondeve. Raportet e auditimeve nga Kontrolli i Lartë i Shtetit shpesh përfshijnë auditime mbi shpenzimet dhe janë të disponueshme publikisht, megjithëse jo gjithmonë përfshihen të dhënat më të fundit dhe as të thjeshtuara për publikun.

Gjithashtu, nëse ndjekim praktikën më të mirë ndërkombëtare për sa i përket informacioneve mbi pasurinë dhe integritetin e anëtarëve të parlamentit, Shqipëria ka shumë vend për përmirësim. Psh. në Kanada, Indi, Afrika e Jugut, ligjvënësit duhet të deklarojnë jo vetëm pasuritë e tyre por edhe të familjarëve, më mënyrë që të shmangët shfrytëzimi i boshllqeve ligjore. Pavarësisht se kjo është një fazë shumë e zhvilluar e transparencës parlamentare, Shqipëria duhet të synojë të ketë më shumë informacion për çdo anëtar të Parlamentit dhe financat e tyre.

⁴⁵ Ligji nr. 10296/2010 i ndryshuar, për menaxhimin financiar dhe kontrollin

⁴⁶ Ligji Nr. 114/2015 i ndryshuar, Për auditimin e brendshëm në sektorin public.

⁴⁷ <https://opendata.al/>

Kriteri 25: Deklarimi i informacionit mbu veprimtari joetike dhe konfliktet e mundshme të interesave.

Parlamenti do të miratojë rregulla të qarta për të siguruar shpërndarjen e informacionit të nevojshëm për të mbrojtur kundër konflikteve të interesit të vërteta ose të perceptuara dhe shkeljeve etike, duke përfshirë informacionin përkatës mbi ndërveprimet e anëtarëve me lobistët dhe grupet e presionit. Parlamenti do të bëjë gjithashtu publik informacionin mbi rezultatet përfundimtare të çdo hetimi gjyqësor ose parlamentar në lidhje me akuzat për sjellje të papërgjegjshme, konflikte interesi ose korrupsion.

Shqipëria ka bërë përparime të dukshme në përmirësimin e transparencës dhe përgjegjshmërisë brenda sistemit të saj parlamentar, veçanërisht lidhur me konfliktet e interesit duke përmbushur 9 nga 10 kërkesat e GRECO në lidhje me këtë fushë⁴⁸. Një zhvillim i rëndësishëm është Sistemi Elektronik për Deklarimin e Pasurive dhe Konfliktet e Interesit, i cili ka për qëllim të përmirësojë monitorimin dhe verifikimin e deklaratave të pasurive nga zyrtarët publikë dhe përfaqësuesit e zgjedhur.⁴⁹

Shqipëria nuk ka implementuar një mekanizëm të tillë që do të sigurojë transparencën në marrëdhëniet ndërmjet parlamentarëve dhe grupeve të interesit, duke e bërë më të vështirë mbikëqyrjen e këtyre marrëdhënieve.

Edhe pse ekzistojnë rregulla për të raportuar sjelljen e pa etikë dhe konfliktet e interesit, shpesh mungon publikimi i rezultateve të hetimeve lidhur me këto çështje. Kjo krijon dyshime mbi integritetin e zyrtarëve dhe ngre shqetësime për transparencën e procesit.

Ka vonesa në miratimin e ligjeve që rregullojnë transparencën dhe përgjegjshmërinë. Ky ngadalësim ndikon negativisht në përmirësimin e situatës dhe integrimin e plotë të standardeve ndërkombëtare në fushën e etikës dhe transparencës.

Kriteri 26: Mundësimi i aksesit mbi informacionin historik.

Informacioni parlamentar për seancat e mëparshme do të digjitalizohet dhe do të bëhet i disponueshëm për qytetarët përgjithmonë, për rishfrytëzim pa kufizime ligjore ose tarifa. Nëse një parlament nuk mund të digjitalizojë dhe të bëjë të disponueshëm informacionin e tij, ai duhet të punojë me organizata të jashtme për të lehtësuar shpërndarjen publike të informacionit parlamentar pa kufizime. Parlamenti duhet të sigurojë akses publik në një bibliotekë parlamentare për të lejuar anëtarët dhe publikun të kenë akses në informacionin historik .

Digjitalizimi i informacionit parlamentar, siç është lartpërmendur , është një nga hapat e bërë për arritjen e këtij kriteri.

Diçka që mund të përmirësohet është krijimi i një biblioteke parlamentare të aksesueshme për publikun. Akoma nuk ka një sistem të plotë dhe të mirëpërcaktuar që garanton aksesin e vazhdueshëm për qytetarët.

SHTYLLA 3: LEHTËSIMI I INFORMACIONIT PARLAMENTAR

Kriteri 27: Mundësimi i disa kanaleve për të aksesuar informacion.

⁴⁸ <https://exit.al/en/albania-satisfies-nine-out-of-ten-greco-recommendations/>

⁴⁹ <https://www.coe.int/en/ëeb/tirana/-/electronic-system-of-declaration-of-assets-and-conflict-of-interests-preventing-corruption-through-increased-transparency-of-assets>

Parlamenti duhet të sigurojë që informacioni të aksesohet në kanale të shumta, duke përfshirë eksperiencën fizike, si p.sh. ditë të hapura në parlament, mediat print dhe online, transmetimet radio dhe televizive, internetit dhe teknologjinë e pajisjeve mobile.

Faqja zyrtare e parlamentit, transmetimet në televizion, në radio, portali e-albania janë disa faktorë shumë të mirë për sa i përket arritjes së këtij kriteri.

Por, ka një mungesë kanalesh të diversifikuara. Informacionet nuk kanë aksesueshmëri nga të gjithë grupimet e qytetarëve, si p.sh. zonat rurale ku ka mungesë të shpeshtë të internetit.

Kriteri 28: Sigurimi i aksesit fizik.

Parlamenti dhe seancat plenare duhet të jenë të aksesueshme fizikisht dhe të hapura për të gjithë qytetarët duke u nënshtruar vetëm kufizimeve të demonstrueshme të sigurisë publike.

Kriteri 29: Garantimi i aksesit nga mediat.

Parlamenti do të sigurojë që mediat dhe vëzhguesit e pavarur të kenë akses të plotë në procedurat parlamentare; kriteret dhe procesi për dhënien e aksesit mediave do të përcaktohen qartë dhe do të jenë të disponueshme publikisht.

Kriteri 30: Mundësia e transmetimeve në kohë reale dhe sipas kërkesës.

Duhet të bëhen përpjekje për të siguruar qytetarët me akses në arkiva në kohë reale dhe me kërkesë në procedurat parlamentare përmes radios, televizionit dhe Internetit.

Shqipëria ka bërë përpjekje në këtë sens duke lejuar mediat të jenë pjesë e seancave plenare. Kjo gjë lejon që qytetarët të marrin informacione mbi seancat plenare ose komisionet të ndryshme, shpesh edhe në kohë reale.

Edhe pse janë të rëndësishme masat e sigurisë për të mbrojtur parlamentarët dhe punonjësit publikë, ndalimi i qytetarëve të vëzhgojnë punimet mund të sjellë një ndjenjë që ata janë të papërshtatshëm. Ajo që është e rëndësishme është që kufizimet të jenë të përcaktuara qartë, të publikohen dhe të jenë të padiskriminueshme.

Vendet si Afrika e Jugut kanë përfshirë aksesin publik në Kushtetutën e tyre, duke bërë që aksesin fizik të jetë një standard i rëndësishëm për transparencën parlamentare. Në Shqipëri, ka një nevojë për përmirësime në këtë aspekt, për të siguruar që të gjithë qytetarët të kenë mundësi të ndjekin veprimtaritë parlamentare dhe të kontribuojnë në procesin demokratik.

Kriteri 31: Lehtësia e aksesit përgjatë shtetit.

Në masën e mundur, aksesimi në informacionin parlamentar nuk do të kufizohet nga barrierat gjeografike. Megjithatë, përdorimi i faqeve të internetit të parlamentit lehtëson aksesin në informacionin parlamentar pa kufizime gjeografike; në vendet ku aksesimi dhe përdorimi i internetit janë të kufizuara, parlamenti duhet të kërkojë mjete të tjera për të siguruar aksesin publik në informacionin parlamentar në të gjithë vendin.

Qeveria ka bërë përpjekje për të ofruar informacion parlamentar përmes faqes zyrtare të Parlamentit, duke e bërë atë më të lehtë për të aksesuar informacion nga qytetarët në mbarë vendin. Disa institucione kanë implementuar sisteme për të pranuar dhe organizuar mendimet e qytetarëve përmes kanaleve si SMS, që ndihmojnë në angazhimin e qytetarëve në proceset ligjore.

Mungesa e Infrastruktues në Zonat Rurale: Ndërsa aksesi online është i dobishëm, shumë qytetarë në zona rurale ndoshta nuk kanë akses të mirë në Internet, gjë që ndikon negativisht në aftësinë e tyre për të marrë informacionin e nevojshëm.⁵⁰

Kufizime Financiare: Çështjet financiare dhe infrastrukturale shpesh pengojnë zbatimin e plotë të strategjive për lehtësimin e aksesit, veçanërisht për ato që kërkojnë investime në teknologji dhe qendra informacioni.

Përfshirja e Niveleve të Ndryshme Sociale: Duhet të bëhen përpjekje të mëtejshme për të siguruar që të gjitha grupet sociale, duke përfshirë ata me të ardhura të ulta, të kenë akses të barabartë në informacionin parlamentar dhe në teknologji.

Kriteri 32: Përdorimi i gjuhës së thjeshtë.

Parlamenti duhet të sigurojë që gjuha ligjore ose teknike të mos shërbejë si një barrierë për qytetarët që kërkojnë të aksesojnë informacionin parlamentar. Ndërsa njihet nevoja për të përdorur një gjuhë të saktë në shkrimin e ligjeve, parlamenti ka detyrimin të zhvillojë përmbledhje në gjuhë të thjeshtë dhe mjete të ngjashme për ta bërë informacionin parlamentar të aksesueshëm dhe të kuptueshëm për anëtarët dhe qytetarët me formim dhe ekspertizë të ndryshme.

Disa institucione kanë filluar të publikojnë përmbledhje dhe informacione në gjuhë të thjeshtë, të cilat janë më të lehta për t'u kuptuar nga ata që nuk kanë një formim juridik. Kjo është e rëndësishme për të inkurajuar pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset demokratike. Shqipëria ka zhvilluar disa iniciativa për të përmirësuar komunikimin e saj me qytetarët, duke përfshirë përdorimin e platformave digjitale për të lehtësuar qasjen në informacionin parlamentar. Kjo përfshin krijimin e portaleve online që ofrojnë informacion të thjeshtëzuar për legjislacionin dhe procedurat parlamentare. Organizatat joqeveritare, si "Instituti i Politikave Publike" dhe "Qendra për Kërkimin dhe Zhvillimin e Politikave", kanë luajtur një rol aktiv në promovimin e transparencës dhe qasjes në informacionin parlamentar, duke kërkuar që qeveria të përdorë gjuhë më të thjeshtë dhe më të kuptueshme për legjislacionin.

Edhe pse ka përpjekje për të krijuar materiale të thjeshta, shpesh herë mungojnë burimet e nevojshme për të zhvilluar këto materiale në mënyrë sistematike. Kjo mund të kufizojë mundësitë për të arritur një publik më të gjerë. Shumë qytetarë nuk janë të vetëdijshëm për këto nisma dhe për mënyrat si mund të aksesojnë informacionin e nevojshëm. Kjo kërkon fushata informuese për të rritur njohuritë mbi përmbajtjen dhe mënyrat e aksesit në informacionin parlamentar

Kriteri 33: Përdorimi i disa gjuhëve kombëtare ose të punës.

Kur Kushtetuta ose rregullat parlamentare parashikojnë përdorimin e shumë gjuhëve kombëtare ose pune në parlament, parlamenti do të bëjë çdo përpjekje të arsyeshme për të siguruar interpretimin e menjëhershëm të seancave dhe përkthimin e shpejtë të regjistrit parlamentar.

Kushtetuta parashikon përdorimin e gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare, por ka njohje të gjuhëve të tjera, siç është gjuha e komuniteteve të ndryshme etnike në vend.

Një nga sfidat kryesore është mungesa e interpretimit të menjëhershëm për procedurat parlamentare. Kjo do të ndihmonte shumë në përfshirjen e qytetarëve që flasin gjuhë të tjera, duke eliminuar diskriminimin në informacionin e ofruar. Shumica e informacionit

⁵⁰ <https://idmalbania.org/research-report-a-decade-of-public-consultation-laë-in-albania-call-for-reform/>

parlamentar është në gjuhën shqipe, dhe përkthimet në gjuhë të tjera janë të pakta. Kjo krijon një barrierë për qytetarët që flasin gjuhë të tjera dhe ndikon negativisht në pjesëmarrjen e tyre në proceset demokratike. Pavarësisht përpjekjeve për të përfshirë qytetarët e komuniteteve të ndryshme, shumë nga ta ndihen të përjashtuar nga procesi parlamentar për shkak të barrierave gjuhësore

Kriteri 34: Sigurimi i aksesit të lirë.

Informacioni parlamentar do të jetë në dispozicion për qytetarët për qasje të pakufizuar, ripërdorim dhe ndarje pa pagesë.

Informacioni mbi projektligjet, ligjet e miratuara dhe diskutimet parlamentare është i disponueshëm në faqen zyrtare të internetit, duke përfshirë gjithashtu dhe rezultatet e votimeve të deputetëve dhe prezencën e tyre në seanca. Seancat parlamentare transmetohen drejtpërdrejt në televizion, çfarë përmirëson transparencën publike.

Disa fusha ende mbeten problematike, veçanërisht lidhur me aksesin e publikut në informacionin mbi buxhetin e shtetit, detajet e prokurimeve publike dhe strukturën organizative të Kuvendit, ku ky institucion ka performancë të ulët. Për më tepër, ndërsa ligji për konsultimin publik ekziston, ka mungesë qartësie mbi mënyrën se si rekomandimet e publikut ndikojnë në procesin legjislativ, çfarë tregon se mekanizmat e hapjes dhe transparencës nuk janë zbatuar ende në mënyrë të plotë dhe efektive.⁵¹

Kriteri 35: Mundësimi i informacionit në struktura transparente dhe të strukturuar.

Informacioni parlamentar do të përgatitet dhe publikohet në një format transparent dhe të strukturuar, si p.sh. XML i strukturuar, që mund të lexohen dhe përpunohen nga kompjuterët, në mënyrë që informacioni parlamentar të mund të ripërdoret dhe analizohet lehtësisht nga qytetarët, shoqëria civile, sektori privat dhe qeveria.

Parlamenti Shqiptar ka përmirësime në lidhje me transparencën e informacionit parlamentar. Ka një përmbushje prej 73% e treguesve për matjen e transparencës institucionale nga ana e parlamentit.⁵²

Parlamenti Shqiptar ende nuk plotëson plotësisht kërkesën për përdorimin e formateve të strukturuar dhe të hapura, si XML. Portali i të dhënave të hapura i Shqipërisë (OpenData)⁵³ ofron të dhëna nga institucione të ndryshme, përfshirë Parlamentin, por shumë prej tyre nuk janë ende në formate të përpunueshme lehtësisht nga softuerët, siç janë formatet XML. Informacioni i paraqitur është shpesh në formate më të thjeshta si PDF ose tabela, të cilat kërkojnë përpunim shtesë për t'u ripërdorur ose analizuar në mënyrë efektive nga palët e interesuara si qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile.⁵⁴

Kriteri 36: Sigurimi i përdorshmërisë së teknologjisë.

Parlamenti duhet të sigurojë përdorshmërinë teknologjike të informacionit parlamentar duke ofruar udhëzime të qarta për përdorimin e çdo baze të të dhënave online ose mjetesh që i mundësojnë qytetarëve të ripërdorin informacionin parlamentar nga faqja e internetit të parlamentit.

⁵¹ <https://www.mjft.org/sites/default/files/Openness%20of%20Parliament%20in%20the%20region%20and%20Albania.pdf>

⁵³ <https://opendata.gov.al/>

⁵⁴ <https://www.mjft.org/sites/default/files/Parliament%20Openness%20Albania.pdf>

Sipas raporteve të fundit, ka përmirësime në ofrimin e qasjes në të dhëna për qytetarët përmes faqeve ëeb zyrtare.

Aksesi nuk është ende plotësisht e thjeshtë dhe e strukturuar për përdoruesit pa njohuri teknologjike të thelluara. Portali zyrtar i Parlamentit ofron një sërë dokumentesh dhe informacionesh për qytetarët, por disa nga sfidat kryesore janë mungesa e udhëzimeve të qarta për përdorimin e bazave të të dhënave dhe mjeteve online. Qytetarët shpesh mund të kenë vështirësi për të gjetur ose përdorur informacionin në formate të lehta për t'u kuptuar dhe orientuar.

Në krahasim me praktikat më të mira ndërkombëtare, të tilla si përdorimi i standardeve E3C për aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara dhe përmirësimin e dizajnit të faqeve për një përdorueshmëri më të lehtë, Shqipëria ende nuk i ka zbatuar plotësisht këto standarde. Implementimi i funksioneve të ndihmës, pyetjeve të shpeshta, dhe kontakteve për mbështetje teknike janë aspekte që duhet të përmirësohen për t'iu ofruar qytetarëve akses më të lehtë dhe pa diskriminim teknologjik.⁵⁵

Kriteri 37: *Mbrojta e privatësisë së qytetarëve.*

Faqet e internetit të parlamentit do të kenë një politikë të qartë dhe të shkurtër për privatësinë për t'i informuar qytetarët se si po përdoren të dhënat e tyre personale. Parlamenti nuk do të përdorë kërkesa për anëtarësim ose regjistrim që kufizojnë aksesin publike në informacionin në faqet e internetit të parlamentit ose lejojnë gjurmimin e informacionit personal të identifikueshëm pa pëlqim të shprehur qartësisht.

Shqipëria ka miratuar ligje dhe rregullore që mbrojnë të dhënat personale, përfshirë Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili është harmonizuar me standardet e BE-së për këtë çështje. Këto ligje ndihmojnë në forcimin e mbrojtjes së privatësisë së qytetarëve. Shumë faqe zyrtare shqiptare nuk kanë një politikë të qartë dhe të lehtë për t'u kuptuar për mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve që i vizitojnë.

Në shumë raste, faqet e institucioneve qeveritare në Shqipëri kërkojnë regjistrim ose informacione identifikuese për të pasur qasje në informacione të caktuara. Kjo bie në kundërshtim me parimin e aksesit të hapur dhe jo-diskriminues ndaj informacionit parlamentar. Nuk ka një qartësi të mjaftueshme për mënyrën se si mbledhen dhe përdoren të dhënat e përdoruesve, dhe qytetarët shpesh nuk kanë dijeni për përpunimin e këtyre të dhënave.

Kriteri 38: *Përdorimi i formateve të hapura dhe softëare-ve me burim të hapur.*

Shumë nga dokumentet dhe të dhënat publike ende lëshohen në formate të pronarit, si PDF ose formate të tjera që janë të lidhura me softëare të caktuar, si Microsoft Office. Kjo pengon aksesin dhe ri-përdorimin e informacionit nga qytetarët, duke e bërë më të vështirë përdorimin e tyre për qëllime të tjera, si hulumtimi ose analiza.⁵⁶

Sipas Sunlight Foundation, qasja pa diskriminim ndaj të dhënave nënkupton që qytetarët duhet të kenë akses pa u kërkuar identifikim apo justifikim për përdorimin e tyre.⁵⁷

Kriteri 39: *Lejimi i shkarkimit për ripërdorim.*

⁵⁵ Ibid.

⁵⁶ <https://www.govloop.com/community/blog/open-formats-and-open-source-for-better-government/>

⁵⁷ <https://sunlightfoundation.com/>

Informacioni parlamentar duhet të jetë i shkarkueshëm lehtësisht, në grup dhe në formate të dokumentuara mirë për të lejuar ripërdorimin e lehtë të informacionit.

Parlamenti shqiptar ofron informacionin në faqen e tij zyrtare.

Aktualisht, Parlamenti shqiptar nuk ofron një mundësi të qartë për shkarkimin në grup të dokumenteve. Informacioni zakonisht duhet të merret dokument për dokument, që e bën procesin më të ngadalshëm dhe më të vështirë për ata që duan të analizojnë të dhënat në masë. Sipas raportit të Botës për e-Parlamentin dhe studimeve të tjera, Shqipëria duhet të përmirësojë mënyrën se si ofron informacionin parlamentar, duke u përputhur më mirë me praktikën më të mira globale. Kjo do të ndihmonte në rritjen e angazhimit qytetar dhe do të lehtësonte analizat e informacionit.

Kriteri 40: *Mirëmbajtja e ëbfaqeve parlamentare.*

Edhe në vendet me përdorim të kufizuar të internetit, mbajtja dhe përditësimi i rregullt i një faqeje parlamentare gjithëpërfshirëse është një aspekt i rëndësishëm i hapjes parlamentare në botën moderne dhe të lidhur. Parlamenti duhet të sigurojë që informacioni parlamentar të jetë në dispozicion në format elektronik dhe të konsiderojë shpërndarjen online si një mjet të domosdoshëm komunikimi.

Nuk ka shumë informacione publike që tregojnë nëse Parlamenti përdor metadata në mënyrë efektive për të lehtësuar kërkimin e informacionit. Kjo është një fushë që mund të ketë nevojë për përmirësim. Gjithashtu ka shumë raste ku sistemi e-albania nuk punon sic duhet ose bllokohet, ndoshta nga mbingarkesa.

Kriteri 41. *Përdorimi i mekanizmave të thjeshtë dhe të qëndrueshëm.*

Parlamenti duhet ta bëjë sa më të lehtë për qytetarët të gjejnë shpejt informacionin parlamentar të dëshiruar, duke krijuar databaza që mundësojnë kërkime të thjeshta dhe të komplikuar përmes përdorimit të metadatave të përshtatshme. Informacioni duhet të jetë i disponueshëm në një vend që mbetet i përhershëm, për shembull, në një faqe interneti me një URL të qëndrueshme.

Parlamenti shqiptar duhet të krijojë baza të dhënash që lejojnë kërkimin e thjeshtë dhe të avancuar të informacionit parlamentar. Kjo do të thotë që informacioni duhet të jetë i organizuar në mënyrë të tillë që qytetarët të mund ta gjejnë lehtësisht atë që po kërkojnë, përfshirë dokumente, ligje dhe aktivitete parlamentare.

Përdorimi i metadata është një faktor i rëndësishëm në lehtësimin e kërkimeve. Metadata ndihmon në klasifikimin dhe përshkrimin e dokumenteve, duke e bërë më të lehtë për qytetarët të gjejnë informacionin e nevojshëm. Parlamenti duhet të adoptojë standarde të miratuara për metadata që do të ndihmojnë në rritjen e efikasitetit të kërkimit. Është thelbësore që informacioni të jetë i disponueshëm në URL të qëndrueshme, që do të thotë se lidhjet e dokumenteve nuk duhet të ndryshojnë me kalimin e kohës. Mjetet si Akoma Ntoso⁵⁸ mund të ofrojnë një kornizë për standardizimin e metadata dhe informacionit ligjor. Këto mjete ndihmojnë në lehtësimin e ndërveprueshmërisë semantike të dokumenteve, duke e bërë më të lehtë për përdoruesit të kuptojnë marrëdhëniet ndërmjet dokumenteve të ndryshme.

Kriteri 42: *Grupimi i informacioneve me kuptim të njejtë.*

⁵⁸ https://ec.europa.eu/isa2/neës/akoma-ntoso-eu-akn4eu-version-30-has-been-published_en

Parlamenti duhet të përpiqet të përmirësojë aftësinë e qytetarëve për të gjetur informacionin parlamentar të rëndësishëm duke lidhur informacionin parlamentar me informacione të tjera të lidhura, për shembull, duke lidhur referencat në historinë e një projekti ligjor me versionet e mëparshme të legjislacionit, me raportet përkatëse të komisioneve, me dëshmitë e ekspertëve, me ndryshimet e sponsorizuara .

Disa parlamente përdorin standarde si RDF për të lidhur dokumentet. Nëse Parlamenti shqiptar përdor standarde të tilla, do të lehtësonte procesin e lidhjes së informacionit dhe do të ndihmonte në krijimin e një strukture më të organizuar të informacionit. Disa vende, si Brazili, kanë zhvilluar platforma si LexML për të unifikuar informacionin legjislativ dhe për të lehtësuar aksesin në të. Aktualisht, nuk ka informacion të qartë nëse Shqipëria ka ndonjë platformë të tillë që mundëson lidhjen e informacionit legjislativ

Kriteri 43: *Mundësimi i përdorimit të shërbimeve të alarmit.*

Kur është e mundur, parlamenti duhet t'u ofrojë qytetarëve mundësinë për t'u abonuar në shërbime që i njoftojnë ata për kategori të caktuara të veprimeve parlamentare përmes përdorimit të emailit, mesazheve SMS ose teknologjive të tjera.

Aktualisht, Parlamenti shqiptar ofron shërbime të njoftimit përmes sistemit të tij të uebit, ku qytetarët mund të informohen për aktivitete dhe ndryshime të rëndësishme, siç janë ligjet dhe aktivitetet e komisioneve.

Megjithatë, informacioni për regjistrimin në shërbime njoftimi përmes emailit ose SMS nuk është aq i përhapur. Në disa raste, informacioni mund të jetë në formë të përgjithshme dhe jo në mënyrë të personalizuar për secilin qytetar. Sipas Raportit të Botës për Parlamentin 2010, rreth 47% e parlamenteve ofrojnë një formë të shërbimit të njoftimit. Në Shqipëri, nuk ka një sistem të konsoliduar që të ofrojë njoftime automatike për qytetarët për ngjarje të rëndësishme.

Kriteri 44: *Lehtësimi i komunikimit të dyanshëm.*

Parlamenti duhet të përpiqet të përdorë mjete teknologjike ndërpevruese për të nxitur aftësinë e qytetarëve që të japin kontribut të rëndësishëm mbi legjislacionin dhe aktivitetin parlamentar, si dhe për të lehtësuar komunikimin me anëtarët ose stafin parlamentar.

Parlamenti shqiptar ka bërë përpjekje për të angazhuar qytetarët përmes faqes së tij zyrtare dhe platformave të mediave sociale.

niveli i ndërveprueshmërisë dhe mekanizmat e reagimit të disponueshëm për qytetarët mbetet i kufizuar.

Aktualisht, nuk ka një sistem të vendosur që lejon qytetarët të ofrojnë reagime në kohë reale ose të angazhohen në diskutime mbi projektligjet përmes një forumi publik, siç shihet në parlamentet e tjera globale.

Ndërsa Parlamenti shqiptar ka një prani në mediat sociale, si Facebook dhe Tëitter, angazhimi shpesh është më shumë i orientuar në transmetimin e informacionit sesa në lehtësimin e dialogut ose mbledhjen e inputeve nga qytetarët.

Sipas Raportit të Botës mbi Parlamentin 2010, ndërsa 88% e parlamenteve ofrojnë informacion kontaktues publik me email, vetëm 18% përdorin grupe diskutimi online për veprimet legjislative. Ky trend është reflektiv i situatës në Shqipëri, ku fokusi është më shumë në ofrimin e informacionit sesa në inkurajimin e pjesëmarrjes aktive.

Kjo analizw narrative e kwtire treguesve qw vlrwsojnw maswn e “parlamentit tw hapur” shoqwrohet mw dy tabelat e mwpposhtme. Tabela e parw jwp njw paraqitje tw thjeshtuar tw progresit qw Parlamenti i Shqipwrisw ka bwrw nw drejtim tw kwtire treguesve. Ndwrsa Tabela 2 jep njw pwrshkrim tw detajuar me burimet pwrkatwse tw kwtire treguesve.

Tabela 1: Masa e avancimit mbi “parlamentin e hapur” në Shqipëri

Nr.	Kriteret	Vleresimi Permbledhes i Progresit			
		Në progres të ngadalshëm	Përpjekje- në pritje të rezultateve	Ka rezultate por ka akoma punë	E përfunduar/ arritur
1	Njohja e të drejtës publike mbi informacionin parlamentar.				
2	Përparimi i kulturës së transparencës nëpërmjet legjislacionit .				
3	Mbrojtja e një kulture transparence nëpërmjet mbikqyrjes.				
4	Promovimi i edukimit të qytetarëve.				
5	Angazhimi u qytetarëve dhe shoqërisë civile.				
6	Mbrojtja e një shoqërie civile të pavarur.				
7	Mundësimi i monitorimit efektiv të Parlamentit.				
8	Shpërndarja e praktikave të mira.				
9	Sigurimi i burimeve ligjore.				
10	Shpërndarja e informacionit të plotë.				
11	Mundësimi i informacionit në kohë.				
12	Sigurimi i infromacionit të saktë.				
13	Miratimi i politikave për transparencën parlamentare.				
14	Mundësimi i informacionit mbi rolet dhe funksionet e Parlamentit.				
15	Mundësimi i informacionit mbi anëtarët e Parlamentit.				
16	Mundësimi i informacionit mbi stafin dhe administratën parlamentare.				
17	Mundësimi i informacionit mbi Agjendën Parlamentare.				
18	Angazhimi i qytetarëve në hartime ligjesh.				

19	Publikimi i regjistrave të seancave të komisionit.				
20	Regjistrimi i votave parlamentare.				
21	Publikimi i regjistrave të seancave plenare.				
22	Publikimi i raporteve të krijuara prej ose për Parlamentin.				
23	Mundësimi informacionit mbi buxhetin dhe shpenzimet.				
24	Deklarimi i pasurive dhe garantimi i integritetit të anëtarëve.				
25	Deklarimi i informacionit mbu veprimtari joetike dhe konfliktet e mundshme të interesave.				
26	Mundësimi i aksesit mbi informacionin historik.				
27	Mundësimi i disa kanaleve për të aksesuar informacion.				
28	Sigurimi i aksesit fizik.				
29	Garantimi i aksesit nga mediat.				
30	Mundësimi i transmetimeve në kohë reale dhe sipas kërkesës.				
31	Lehtësimi i aksesit përgjatë shtetit.				
32	Përdorimi i gjuhës së thjeshtë.				
33	Përdorimi i disa gjuhëve kombëtare ose të punës.				
34	Sigurimi i aksesit të lirë.				
35	Mundësimi i informacionit në struktura transparente dhe të strukturuar.				
36	Sigurimi i përdorshmërisë së teknologjisë.				
37	Mbrojta e privatësisë së qytetarëve.				
38	Përdorimi i formateve të hapura dhe softëare-ve me burim të hapur.				
39	Lejimi i shkarkimit për ripërdorim.				

40	Mirëmbajtja e ëebfaqeve parlamentare.				
41	Përdorimi i mekanizmave të thjeshtë dhe të qëndrueshëm.				
42	Grupimi i informacioneve me kuptim të njëjtë.				
43	Mundësimi i përdorimit të shërbimeve të alarmit.				
44	Lehtësimi i komunikimit të dyanshëm.				

Tabela 2: Përmbledhje e vlerësimit të treguesve të parlamentit të hapur në Shqipëri

Shtylla	Kriteri	Standardi për arritjen e kriterit	Vlerësimi për parlamentin shqiptar	Burimi	
Promovimi i një kulturë transparence	1. Njohja e të drejtës së publikut mbi informacionin parlamentar	Informacioni parlamentar i përket publikut; qytetarët duhet të lejohen të ripërdorin dhe ribotojnë informacionin parlamentar, në tërësi ose pjesërisht. Çdo përjashtim ose kufizim nga ky parim duhet të përcaktohet me saktësi dhe në mënyrë të detajuar nga ligji.	Në përputhje: Ka disa kufizime në aksesin e disa dokumenteve sensitive të cilat lidhen me sigurinë kombëtare, privatësinë ose informacionin konfidencial, por pavarësisht se kjo mund të krijojë kufizime në aksesimin e informacionit, ligji i përcakton qartë këto kufizime (ligji 119/2014 i ndryshuar) dhe sipas këtij kriteri numër 1, janë në përputhje.	Për tu përmirësuar: Megjithëse informacioni është i disponueshëm, formati në të cilin ofrohet mund të kufizojë ripërdorimin. Për shembull, disa dokumente janë në formate që nuk mund të lexohen automatikisht nga makineritë (p.sh., PDF), dhe kjo e kufizon lehtësinë e analizës apo ripërdorimit nga qytetarët ose palët e treta	Ligji 119/2014 i ndryshuar, mbi të drejtën e informimit. Rregullorja e brendshme e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (Neni 105 me i rëndësishëm, neni 106 e, neni 107 dh)
	2.Përparimi i kulturës së transparencës nëpërmjet legjislativitetit	Parlamenti ka detyrimin të miratojë legjislativitetin, si dhe rregulla të brendshme procedurale dhe kode të sjelljes, që të krijojnë një ambient që garanton të drejtën e publikut për informacionin e qeverisë dhe parlamentit, promovon një kulturë të qeverisjes së hapur, siguron transparencën e financimit politik, mbron liritë e shprehjes dhe të asamblesë, dhe siguron angazhimin e shoqërisë civile dhe qytetarëve në procesin legjislativ.	Në përputhje: Egzistojnë kuadere ligjore të cilat synojnë të lehtësojnë angazhimin e publikut në procesin legjislativ, si psh Ligji Nr. 146/2014 për Njoftimin dhe Konsultimin Publik është një instrument kyç për promovimin e transparencës dhe angazhimin të shoqërisë civile në proceset legjislativ në Shqipëri. Ky ligj synon të sigurojë që qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile të kenë mundësi të kontribuojnë dhe të japin mendime për politikën dhe ligjet që ndikojnë në jetën e tyre	Për t'u përmirësuar: Pavarësisht faktit që kuadere të tilla ligjore ekzistojnë, shpesh ndodh që autoritetet publike e neglizhojnë procesin e konsultimit me publikun. Kjo mund të shkaktojë një dëm në cilësinë e ligjeve dhe politikave si edhe gjithashtu të ulë besimin e publikut në ndikimin që kanë në procesin legjislativ. Gjithashtu studime të ndryshme tregojnë se ka një mungesë mekanizmesh për të marrë reagimet dhe "feedback-un" e publikut. Ka gjithashtu një gjykim se bashkëpunimi i parlamentit me publikun është sipërfaqësor dhe jo i mjaftueshëm. (Raport nga Instituti për demokraci dhe ndërmjetësim)	https://idmalbania.org/research-report-a-decade-of-public-consultation-laë-in-albania-call-for-reform/ "Një dekadë e ligjit të konsultimeve publike në Shqipëri: Thirrje për reformë" https://idmalbania.org/report-cso-participation-in-decision-making-in-albania/ "Pjesëmarrja e shoqërisë civile në vendimarrje në Shqipëri"
	3. Mbrojtja e një kulture transparencë nëpërmjet mbikëqyrjes	Në përmbushjen e funksionit të tij të mbikëqyrjes, parlamenti do të garantojë që ligjet që sigurojnë hapjen e qeverisë të zbatohen në mënyrë efektive, që qeveria të veprojë në një mënyrë plotësisht transparente, dhe që qeveria gjithashtu të punojë për të	Në përputhje: Ka mekanizma mbikëqyrje dhe kuadere ligjore (ligjet e lartpërmendura) të cilat e ndihmojnë përmbushjen e këtij kriteri si psh ligji mbi të drejtën e informimit. Shqipëria është angazhuar në disa marrëveshje rajonale dhe ndërkombëtare, si Partneriteti për	Për t'u përmirësuar: Megjithëse këto mekanizma ekzistojnë, zbatimi i ligjit për të drejtën e informimit është i mangët. Ekzistojnë mungesa dhe vonesa në informacion, faktor ky i cili bie në kundërshtim me parimin e transparencës parlamentare.	https://ogp.gov.al/faqe/cfare-eshte https://birn.eu.com/netëork/birn-albania/ https://ais.al/neë/

	promovuar një kulturë transparence.	Qeverisje të Hapur (PQH), që synon rritjen e transparencës së qeverisë dhe angazhimit të qytetarëve. Raportet parlamentare dhe progresi në lidhje me këto angazhime tregojnë përputhshmëri me normat globale për transparencën.	Raportimet e shoqatave si BIRN Albania (Balkan Investigative Reporting Network) dhe AIS (Albanian Institute of Science) shumë institucione publike në Shqipëri kanë vonuar ose nuk kanë dhënë përgjigje për kërkesat e paraqitura në bayë të Ligjit për të Drejtën e informimit. (flet më tepër për vështirësinë në marrjen e informacioneve nga ministrinë dhe bashkitë lidhur me kontratat publike ose shpërndarjen e fondeve)	
4. Promovimi i edukimit të qytetarëve	Parlamenti ka përgjegjësinë të promovojë aktivisht edukimin e qytetarëve, veçanërisht të rinisë, duke promovuar kuptimin e rregullave dhe procedurave të parlamentit, dhe anëtarëve të tij.	Në përputhje: Parlamenti shqiptar është përpjekur të rrisë edukimin e qytetarëve mbi informacionin parlamentar. Disa shembuj të kësaj janë ditët e hapura që organizohen në disa raste nga parlamenti për studentët, faqja e ëeb e parlamentit, shpërndarja e broshurave me informacione të ndryshme mbi parlamentin, programi Rinia dhe Kuvendi.	Për tu përmirësuar: Shumë programe edukative, si vizitat e shkollave në Parlament ose vizitat e mundshme të punonjësve të parlamentit në këto shkolla mund të mos arrijnë të gjitha rajonet e Shqipërisë, veçanërisht zonat rurale ku qasja në këto iniciativa mund të jetë e kufizuar. Ka gjithashtu një mungesë promovimi për aktivitetet informuese që mund të organizojë parlamenti, kështuqë njerëzit nuk kanë dijeni për këto aktivitete. Nuk ka një mënyrë monitorimi për programet edukative për sa i përket efikasitetit dhe cilësisë së tyre. Duhet të krijohet një mënyrë që qytetarët të shprehin përshtypjet dhe sugjerimet e tyre mbi këto mekanizma edukimi të pordhuara nga Parlamenti.	https://www.eda.admin.ch/countries/albania/en/home/international-cooperation/projects.html/content/dezaprojects/SDC/en/2017/7F09576/phase1
5. Angazhimi i qytetarëve dhe shoqërisë civile	Parlamenti ka detyrimin të angazhojë aktivisht qytetarët dhe shoqërinë civile, pa diskriminim, në proceset dhe vendimmarrjet parlamentare, me qëllim që të përfaqësojë në mënyrë efektive interesat e qytetarëve dhe të japë efekt për të drejtën e qytetarëve për	Në përputhje: Parlamenti shqiptar ka nisur iniciativa për të rritur angazhimin e qytetarëve, si përmes dëgjësave publike dhe konsultimeve online për legjislacionin. Megjithatë, ka shqetësime lidhur me efektivitetin dhe transparencën e këtyre përpjekjeve	Për tu përmirësuar: OSBE ka vënë në dukje se, megjithëse ekziston një kornizë ligjore që mbështet pjesëmarrjen publike, zbatimi i saj shpesh mungon në arritjen e grupëve të ndryshme të qytetarëve <ul style="list-style-type: none"> • Procesi parlamentar në Shqipëri përballet me pengesa për të siguruar që të gjitha demografitë—pa marrë 	https://www.partnersalbania.org/publication/participation-of-civil-society-and-citizens-in-decision-making/ https://citizens.al/en/2024/04/11/the-report-of-freedom-house-democracy-in-Albania-no-improvement/

	të bërë kërkesë ndaj qeverisë së tyre.		<p>parasysh gjininë, etninë, moshën ose aftësinë—të jenë aktivisht të angazhuara. Raportet sugjerojnë se, ndërsa disa përpjekje bëhen për të përfshirë grupet e marginalizuara, si personat me aftësi të kufizuara, këto iniciativa ndoshta nuk janë të mjaftueshme për të garantuar pjesëmarrjen e tyre efektive në vendimmarrje.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Standarde dhe Rekomandime Ndërkombëtare: Parlamenti Evropian dhe organe të tjera ndërkombëtare theksojnë nevojën për parlamentet që jo vetëm të ofrojnë informacion, por të krijojnë mundësi për kontributin e publikut në procesin legjislativ. Kjo përfshin platforma për feedback qytetar, si petitionet elektronike dhe diskutimet publike <p>Praktikat aktuale të Shqipërisë duhet të përputhen më afër me këto standarde për të përmirësuar ndjeshëm angazhimin e qytetarëve.</p>	
6.Mbrojtja e një shoqërie civile të pavarur.	Parlamenti ka detyrimin të mbështesë masat për të siguruar që organizatat e shoqërisë civile të jenë në gjendje të operojnë lirisht dhe pa kufizime.	Në përputhje: Kuatro ligjor mbetet një mjet shumë i rëndësishëm për arritjen e këtij kriteri. Ligjet e lartpërmendura janë një mënyrë që parlamenti shqiptar ka synuar të arrijë ta përmbushë. Gjithashtu, ka nisur një kulturë për përfshirjen e qytetarëve nëpërmjet dëgjësive publike dhe konsultimeve.	Për tu përmirësuar: Sipas ligjeve ndërkombëtare, siç janë Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, shtetet kanë obligimin të mbrojnë të drejtat e organizatave civile. Megjithatë, organizatat në Shqipëri shpesh hasin pengesa në funksionimin e tyre për shkak të mungesës së mbështetjes nga institucionet shtetërore dhe frikësimit të mundshëm nga represioni/ ndrydhja që mund të hasin.	<p>https://www.un.org/en/about-us/universal-declaration-of-human-rights</p> <p>https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/international-covenant-civil-and-political-rights</p>

7. Mundësi mi i Monitorimit efektiv të Parlamentit	Parlamenti duhet të njohë të drejtën dhe detyrën e shoqërisë civile, medias dhe publikut për të mbikëqyrur parlamentin dhe parlamentarët. Parlamenti do të angazhohet në konsultime me publikun e dhe organizatat e shoqërisë civile që mbikëqyrin parlamentin për të inkurajuar mbikëqyrjen efektive dhe për të reduktuar pengesat në aksesimin e informacionit parlamentar.	Në përputhje: Parlamenti shqiptar ka angazhuar në nisma të ndryshme për të rritur pjesëmarrjen publike dhe konsultimet. Kjo përfshin dëgjime publike, konsultime mbi projektligje, dhe bashkëpunime me OSHC për të promovuar dialogun ndërmjet qytetarëve dhe parlamentarëve. Parlamenti synon të lejojë organizata të ndryshme të monitorojnë tentativat dhe lëvizjet e parlamentit për të arritur transparencë.	Për tu përmirësuar: mbeten sfida në lidhje me nivelin e përfshirjes publike dhe efektivitetin e këtyre konsultimeve.	
8. Shpërndarja e praktikave të mira	Parlamenti do të marrë pjesë aktivisht në shkëmbime ndërkombëtare dhe rajonale të praktikave të mira me parlamente të tjera dhe me organizatat e shoqërisë civile për të rritur transparencën e informacionit parlamentar, për të përmirësuar përdorimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit, dhe për të forcuar përmbushjen e parimeve demokratike	Në përputhje: Shqipëria ka marrë pjesë në disa organizata ndërkombëtare që promovojnë transparencën dhe përmirësimin e qeverisjes, siç është Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës dhe IPU (Unioni Ndërkombëtar i Parlamentarëve). Këto platforma ofrojnë mundësi për shkëmbimin e praktikave të mira dhe përmirësimin e transparencës parlamentare	Për tu përmirësuar: Pjesëmarrja e Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare parlamentare shpesh është e kufizuar. Ndërsa anëtarësimi egziston, angazhimi aktiv dhe kontributet në diskutime janë minimale.	https://www.mjaft.org/en/reports/report-albanian-parliament-openness https://www.google.com/search?q=kuvendi+i+shqiperise&og=kuvendi&gs_lcrp=EgZjaHJvbEUqBggAEEUYOzIGCAAQRRq7MhAlARAUzGIMBGNQCGLLEDGIAEMgclAhAAGIAEMgclAxAAGIAEMgclBBAAGIAEMgclIBRAAGIAEMgYIBhBFGD0yBggHEEUYPdIBCDE1MTlqMGo0qAlAsAIA&sourceid=chrome&ie=UTF-8
9. Sigurimi i burimeve ligjore	Parlamenti duhet të miratojë legjislacion për të siguruar që qytetarët të kenë akses efektiv në mjete ligjore ose gjyqësore në rastet kur akses i qytetarëve në informacionin e qeverisë ose parlamentit është në diskutim.	Në përputhje: Shqipëria ka një ligj që rregullon aksesimin e informacionit publik, Ligji nr. 119/2014 për të Drejtën e Informimit. Ky ligj synon të sigurojë që qytetarët të kenë akses të lehtë në informacionin që ata kërkojnë nga institucionet shtetërore.	Për tu përmirësuar: Sipas një raporti të publikuar nga Lëvizja Mjaft, Shqipëria plotëson vetëm 60% të kriterëve të transparencës parlamentare, çka tregon se duhet të përmirësojë disa aspekte për të përmbushur standardet ndërkombëtare	https://www.mjaft.org/en/reports/report-albanian-parliament-openness
10. Shpërndarja e	Informacioni parlamentar i disponueshëm për publikun duhet të jetë sa më i plotë të jetë e	Në përputhje: Ligjet dhe rregulloret aktuale për transparencën kërkojnë që Parlamenti të	Për tu përmirësuar: ky proces shpesh është i kufizuar nga mungesa e përditësimeve të rregullta dhe	Raporti i Mjaft. IDM Albania

informacionit të plotë	mundur, duke reflektuar tërësinë e veprimeve parlamentare, me përjashtim të rasteve të përcaktuara me detaje dhe saktësisht.	publikojë informacione mbi ligjet, seancat plenare, komisionet, si dhe dokumentet shoqëruese.	aksesit të plotë në të gjitha materialet relevante. Sipas një raporti të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), në Shqipëri, publikimi i dokumenteve parlamentare është shpesh fragmentar, duke munguar dokumentet mbështetëse që janë thelbësore për të kuptuar kuadrin e plotë të veprimtarive ligjore të Kuvendit. Për shembull, shpesh mungojnë raportet e komisioneve dhe amendamentet e propozuara, të cilat janë jetike për të kuptuar plotësisht procesin ligjvënës dhe për të mundësuar përfshirjen e qytetarëve në vendimarrje.	
11. Mundësimi i informacionit në kohë	Informacioni parlamentar do t'i ofrohet publikut në një kohë të duhur. Si rregull i përgjithshëm, informacioni do të ofrohet në kohë reale. Në rastin kur kjo është e pamundur, informacioni parlamentar do të publikohet sa më shpejt që të jetë i disponueshëm në brendësi.	Në përputhje: Raportet parlamentare dhe dokumentet e komisioneve bëhen publike sipas rregullores së Kuvendit dhe praktikave të vendosura për transparencë. Në përgjithësi, raportet dhe dokumentet e tjera shpërndahen pas shqyrtimit dhe miratimit në komisione ose seanca plenare, duke i bërë ato të aksesueshme për publikun në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë.	Për tu përmirësuar: Në shumë raste publikimi i dokumenteve në Shqipëri nga Parlamenti, ndodh pas disa ditësh. Raporti i eorld e-Parliament sugjeron që dokumentet të bëhen publike brenda 24 orëve pas përgatitjes. Në Shqipëri, mungon një rregullim i qartë ligjor për publikimin e agjendave dhe dokumenteve të komisioneve brenda afateve të caktuara. Kjo krijon pengesa për pjesëmarrjen e shoqërisë civile dhe qytetarëve në diskutimet e rëndësishme ligjore. Vënde si Greqia dhe India , i bëjnë të disponueshme për publikun informacionet parlamentare brenda 24 orëve.	
12. Sigurimi i informacionit të saktë	Parlamenti do të sigurojë një proces për të ruajtur regjistrat autoritarë dhe për të garantuar që informacioni që publikon për publikun të jetë i saktë.	Në përputhje: Kuvendi i Shqipërisë, përmes praktikave dhe rregulloreve të tij, synon të sigurojë që informacioni i lëshuar për publikun të jetë i saktë dhe i plotë. Një proces që	Për tu përmirësuar: Në nivel ndërkombëtar, praktikat për të garantuar saktësinë e informacionit përfshijnë përdorimin e standardeve të hapura për dokumentet, si dhe sistemet	

			<p>ndihmon në këtë aspekt është dokumentimi dhe publikimi i procesverbaleve të seancave plenare dhe komisioneve, ku rregullat e brendshme të Kuvendit përcaktojnë afate dhe mekanizma për verifikimin e saktësisë së tyre përpara publikimit. Kjo praktikë është në përputhje me standardet ndërkombëtare për transparencë parlamentare, ku kërkohet që të gjitha dokumentet dhe informacionet të jenë të verifikuara përpara se të bëhen publike</p>	<p>e shënimit (markup) të bazuara në XML për të minimizuar gabimet njerëzore dhe për të përmirësuar saktësinë në përpunimin dhe publikimin e dokumenteve legjislativ. Për shembull, Parlamenti Evropian përdor një sistem të tillë për të siguruar që të gjitha ndryshimet dhe ndryshimet në legjislacion të ruhen individualisht dhe të verifikohen për saktësi. Përdorimi i formateve të hapura si XML për dokumentet legjislativ në Shqipëri nuk është aq i përhapur sa në disa parlamente të tjera, siç është Parlamenti Evropian.</p> <p>Në disa raste, institucionet shqiptare kanë treguar interes për adoptimin e teknologjive të përparura për ruajtjen dhe shpërndarjen e informacionit. Megjithatë, nuk ka të dhëna të qarta që të tregojnë përdorimin e XML si standard i miratuar gjerësisht në nivelin parlamentar për publikimin e ligjeve ose të dhënave të tjera zyrtare.</p>	
Të arrihet informacioni parlamentar transparent	13. Miratimi i politikave për transparencën parlamentare.	Parlamenti do të miratojë politika që sigurojnë shpërndarjen proaktive të informacionit parlamentar, duke përfshirë politikën në lidhje me formatet në të cilat ky informacion do të publikohet. Politikën e transparencës parlamentare do të jenë të disponueshme publikisht dhe do të specifikojnë kushtet për rishikimin e tyre periodik për të shfrytëzuar zhvillimet teknologjike dhe të praktikave të mira. Kur parlamenti nuk mund të ketë kapacitetin e menjëhershëm për të publikuar informacion të plotë	<p>Në përputhje:</p> <p>Ligji “Për të Drejtën e Informimit” siguron aksesin publik në dokumentet parlamentare.</p> <p>Në Shqipëri ka përmirësime në legjislacion, si krijimi i Avokatit të Popullit për të trajtuar çështjet e aksesit në informacion.</p>	<p>Për tu përmirësuar:</p> <p>Ende nuk ka një politikë të qartë dhe të plotë për transparencën që të përmbushë plotësisht praktikën më të mirë ndërkombëtare të përshkruara në këtë dispozitë. (13)</p> <p>ungon një plan strategjik publik që të përfshijë rishikime periodike të politikave të transparencës për të përfituar nga përparimet teknologjike, sikurse është praktikuar në vende si Kanadaja dhe Mbretëria e Bashkuar.</p>	

	parlamentar, ai duhet të zhvillojë partneritete me shoqërinë civile për të siguruar akses të gjerë publik në informacionin parlamentar.			
14. Mundësimi i informacionit mbi rolës dhe funksionet e Parlamentit	Parlamenti duhet të bëjë të disponueshëm informacion mbi rolin e tij kushtetues, strukturën, funksionet, rregullat e brendshme, procedurat administrative dhe fluksin e punës, si dhe të njëjtat informacione për komisionet e tij.	Në përputhje: Parlamenti Shqiptar ka bërë disa përpjekje për të përmbushur parimin e ofrimit të informacionit mbi rolet dhe funksionet e tij duke u bayuar në aspekte si më poshtë: Kudri ligjor: Neni 22 i Kushtetutës bën të qartë të drejtën e shoqërisë civile për të patur akses në informacione publike, përveç rasteve të përcaktuara me ligj. Faqja zyrtare e Parlamentit ofron informacion mbi rolet e Parlamentit.	Për tu përmirësuar: Ka ende hapësira për përmirësim, sidomos në lidhje me qartësinë dhe aksesin ndaj këtij informacioni. Pjesëmarrja e qytetarëve në proceset legjislativë mund të përmirësohet përmes burimeve edukative dhe mjeteve interaktive. Kjo përfshin përdorimin e videove edukative dhe burimeve të tjera interaktive, ashtu siç janë zbatuar në vende të tjera, siç është Mbretëria e Bashkuar.	
15. Mundësimi i informacionit mbi anëtarëve të parlamentit	Parlamenti do të ofrojë informacion të mjaftueshëm dhe të përditësuar rregullisht për qytetarët për të kuptuar akreditimet e një anëtar, lidhjen me partinë, mandatin zgjedhor, rolet në parlament, frekuentimin, identitetet e stafit personal, si dhe çdo informacion tjetër që anëtarët dëshirojnë të zbulojnë për veten e tyre dhe akreditimet e tyre. Informacioni i kontaktit të punës për zyrat parlamentare dhe ato të njësi zgjedhore të anëtarëve gjithashtu do të jetë i disponueshëm për publikun.	Në përputhje: • Faqja zyrtare e Parlamentit shqiptar ofron disa informacione mbi anëtarët, përfshirë emrat, përfaqësimin partiak dhe komitetet në të cilat ata shërbejnë.	Për tu përmirësuar: • Megjithatë, informacioni mund të jetë më i detajuar dhe i aksesueshëm për qytetarët. Informacione më të detajuara për mandatin zgjedhor, përvojën profesionale, dhe historinë e karrierës së anëtarëve shpesh mungojnë ose janë të limituara. Në disa raste, informacioni mbi stafin personal të anëtarëve dhe rolet e tyre të tjera jashtë parlamentit është i papërfshirë. Sipas udhëzimeve të IPU, shumë parlamente në botë ofrojnë informacione të detajuara për anëtarët e tyre, duke përfshirë biodata, foto, informacion për komitetet dhe aktivitetet parlamentare. Për shembull, Parlamenti i Afrikës së Jugut ka një sistem të mirë të organizuar për të ofruar këtë informacion. Një sugjerim është që Parlamenti Shqiptar të adoptojë praktikat më të	https://www.ipu.org/

				<p>mira ndërkombëtare duke krijuar një platformë online ku çdo anëtar mund të ketë një faqe personale me informacion të detajuar mbi karrierën e tij, aktivitetet legislative, dhe mënyrat e kontaktit me qytetarët. Kjo do të ndihmonte në rritjen e angazhimit të qytetarëve dhe besimit në institucionet parlamentare.</p>	
16. Mundësimi i informacionit mbi stafin dhe administratën parlamentare	Parlamenti do të bëjë të disponueshëm informacion mbi funksionimin e tij administrativ dhe strukturën e stafit parlamentar që menaxhon dhe administron proceset parlamentare. Informacioni i kontaktit për stafin përgjegjës për ofrimin e informacionit për publikun duhet të jetë publikisht i disponueshëm.	Në përputhje: Në faqjen zyrtare të parlamentit, jepen informacione mbi këto faktorë si psh: informacioni për funksionin e tij.	<p>Për tu përmirësuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> Aktualisht, informacioni për stafin dhe administratën është mëse i kufizuar, duke mos përfshirë detaje të plota mbi identitetin dhe përgjegjësitë e çdo anëtari të stafit. <p>Sipas praktikave të mira, informacioni si numrat e kontaktit dhe përgjegjësitë e stafit që ofrojnë informacion për publikun duhet të jenë të disponueshme. Në Shqipëri, kjo praktikë ende nuk është e standardizuar, duke i lënë qytetarët pa një menyrë aksesimi të qartë dhe të thjeshtë për të kontaktuar stafin administrativ. Një hap përpara do të ishte krijimi i një organigrami të administratës parlamentare, duke përfshirë rolet, përgjegjësitë dhe buxhetin e secilës njësi. Kjo do të ndihmonte në rritjen e besimit të qytetarëve dhe do të sigurojë që administrata parlamentare të veprojë në interes të publikut.</p>		
17. Informimi i qytetarëve mbi Axhendën Parlamentare	"Dokumentacioni në lidhje me planifikimin e punëve parlamentare do të ofrohet për publikun, duke përfshirë kalendarin e seancave, informacionin rreth votimeve të planifikuara, rendin e punës dhe orarin e dëgjësve në komisione. Përveç rasteve të rralla që lidhen	Në përputhje: Parlamenti shqiptar ka përmirësuar praktikën e tij në publikimin e kalendarëve të punës dhe rendit të ditës për seancat e tij. Sipas informacionit nga faqja zyrtare e Parlamentit, informacioni rreth seancave të planifikuara, votimeve dhe komisioneve shpallet në mënyrë të	<p>Për tu përmirësuar:</p> <p>Shpesh ndodhin vonesa në publikimin e agjendës, duke penguar mundësinë për një angazhim të plotë nga ana e qytetarëve. Organizata ndërkombëtare si Komisioni Evropian dhe OECD kanë dhënë rekomandime për përmirësimin e transparencës dhe angazhimit të</p>	<p>https://publicadministration.desa.un.org/publications/ëo-rid-e-parliament-report-2010</p>	

	me legjislacionin urgjent, parlamenti do të ofrojë njoftim të mjaftueshëm përpara për të lejuar publikun tu japin sugjerime dhe kontribut anëtarëeve në lidhje me çështjet që janë në shqyrtim.	rregullt, duke lejuar kështu që qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile të angazhohen më lehtë në proceset legjislative	qytetarëve në proceset legjislative në Shqipëri. Sipas Raportit Botëror të Parlamentit Dixhital 2010, 85% e faqeve të internetit të parlamenteve publikojnë orare të përditshme, me 70% që ofrojnë kalendarin e plenareve të paktën dy ditë para takimeve Këto rekomandime përfshijnë rritjen e aksesit në informacion dhe përmirësimin e komunikimit midis parlamenteve dhe qytetarëve.	
18. Angazhimi i qytetarëve në hartime ligjesh.	Legjislacioni i hartuar do të bëhet publik dhe do të publikohet me hyrjen e tij. Duke njohur nevojën që qytetarët të jenë plotësisht të informuar dhe të japin kontribut për çështjet që janë në shqyrtim, parlamenti do të përpiqet të sigurojë akses publik në analizat përgatitore dhe informacionin e prapavijës për të inkurajuar një kuptim të gjerë të diskutimeve mbi politikën në lidhje me legjislacionin e propozuar.	Në përputhje: <ul style="list-style-type: none"> Hartimi i legjislacionit në përgjithësi bëhet publik në momentin e prezantimit të tij. Asambleja Shqiptare ka një faqe zyrtare ku publikohen dokumentet legjislative, duke përfshirë ligjet e propozuara, amendamentet dhe raportet. Asambleja ka bërë hapa përpara në ofrimin e qasjes në informacionin legjislativ. Për shembull, platforma “E-Albania” lejon qytetarët të shohin dokumente të ndryshme qeveritare, duke përfshirë hartimet/draftet e ligjeve. Asambleja Shqiptare ka nisur konsultime publike për disa projektligje. Këto konsultime përfshijnë kërkesën për reagime nga shoqëria civile, grupet e interesit dhe publiku në përgjithësi.	Për tu përmirësuar: <ul style="list-style-type: none"> ndërsa ligji kërkon që dokumentet të jenë të aksesueshme, ka shqetësime në lidhje me shkallën e vetëdijes dhe kuptimit të publikut për këto dokumente Niveli i detajeve dhe analizës së ofruar bashkë me këto dokumente mund të ndryshojë, duke çuar në pasiguri për sa mirë janë të informuar qytetarët mbi legjislacionin Raportet tregojnë se ndërsa organizatat e shoqërisë civile shpesh marrin pjesë në këto diskutime, shkalla e ndikimit të tyre në rezultatet përfundimtare legjislative mund të jetë e kufizuar. Shumë qytetarë mund të mos jenë të vetëdijshëm për kalendarin legjislativ ose mundësitë për të ofruar mendimin e tyre. Kjo është pjesërisht për shkak të fushatave të pamjaftueshme të informimit dhe vetëdijes nga Asambleja.	https://www.rti-rating.org/ep-content/uploads/Albania.pdf Raporti i MJAFT.
19. Publikimi i regjistrave të	Raportet e procedurave të komisioneve, duke përfshirë dokumentet e krijuara dhe të pranuar, dëshmitë e dëshmitarëve	Në përputhje: <ul style="list-style-type: none"> Legjislacioni shqiptar parashikon që raportet e procedurave të komisioneve, përfshirë dokumentet e 	Për tu përmirësuar: <ul style="list-style-type: none"> Ndonjëherë ka vonesa në publikimin e këtyre informacioneve, duke ulur transparencën e procesit . 	

	seancave të komisionit	në dëgjesat publike, transkriptet dhe regjistrat e veprimeve të komisioneve, duhet të bëhen publike shpejtë.	<p>krijuara dhe të pranuar, dëshmitë e dëshmitarëve gjatë dëgjesave publike, dhe regjistrat e veprimeve të komisioneve, duhet të bëhen publike menjëherë.</p> <ul style="list-style-type: none"> Ligji e lejon që dëgjesat dhe takimet e komisioneve të jenë të hapura për publikun, në mënyrë që qytetarët të kenë akses në informacionin që formon vendimet legjislative. 	Pavarësisht se ligji e lejon këtë transparencë të dëgjesave dhe takimeve të komisioneve, zbatimi i tij është i papërsosur.	
20.	Regjistrimi i Votave Parlamenta re	Për të siguruar përgjegjësinë e anëtarëve ndaj elektoratit për sjelljen e tyre në votim, parlamenti do të minimizojë përdorimin e votimit me zë në plenare dhe do të përdorë votimin me thirrje emri ose votimin elektronik në shumicën e rasteve, duke mbajtur dhe bërë të disponueshëm për publikun një regjistër të sjelljes së votimit të anëtarëve të veçantë në plenare dhe në komisione. Po ashtu, parlamenti do të minimizojë përdorimin e votimit me mandat dhe do të sigurojë që kjo të mos dëmtojë normat e transparencës dhe përgjegjësisë demokratike.	Në përputhje: Në Shqipëri, votimi elektronik përdoret shpesh në seancat plenare të parlamentit dhe rezultatet e votimeve shpallen në faqen zyrtare të Kuvendit. Kjo ofron një farë transparence për sa i përket sjelljes së deputetëve gjatë votimeve.	Për tu përmirësuar: Megjithatë, diskutimet në komisionet parlamentare shpesh mbahen me dyer të mbyllura, duke limituar mundësinë për akses të drejtpërdrejtë nga publiku në procesin e votimit të komisioneve. Një aspekt që kërkon përmirësim është minimizimi i përdorimit të votimit me zë dhe zbatimi më i gjerë i votimit elektronik ose me thirrje emrash, që siguron se vota e secilit deputet regjistrohet dhe bëhet publike.	
21.	Publikimi i regjistrave të seancave plenare	Parlamenti do të krijojë, mbajë dhe publikojë regjistra të lehtë për t'u aksesuar të procedurave të tij plenare, idealisht në formën e regjistrimeve audio ose video, të mbajtura online në një vend të përhershëm, si dhe në formën e një transkripti të shkruar ose Hansard.	Në përputhje: Në Shqipëri, seancat plenare transmetohen drejtpërdrejt dhe janë të regjistruara, duke iu ofruar qytetarëve mundësinë për të ndjekur aktivitetet e parlamentit përmes kanaleve mediatike dhe internetit. Faqja zyrtare e Kuvendit të Shqipërisë përfshin rendin e ditës, dokumentet e depozituara dhe regjistrimet e seancave, duke	Për tu përmirësuar: Ekziston një mundësi për të përmirësuar formatin e të dhënave, duke i bërë ato më të hapura për analiza nga shoqëria civile dhe organizata të tjera. ekziston nevoja për të forcuar më tej publikimin e transkriptimeve të shkruara të debatit parlamentar, të cilat në shumë raste nuk janë plotësisht të aksesueshme nga publiku.	https://www.ipu.org/

			përbushur disa nga këto kritere të transparencës.		
22. Publikimi i raporteve të krijuara prej ose për Parlamentin	Të gjitha raportet e krijuara nga parlamenti ose që kërkohen të dorëzohen në parlament, zyrat e tij ose komision, do të bëhen publike në tërësi, përveç në rrethana të përcaktuara saktësisht dhe me detaje nga ligji.	Në përputhje: Me miratimin e Ligjit Nr. 146/2014 për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, synohet forcimi i hapjes institucionale. Ky ligj kërkon që procesi legjislativ të jetë i hapur dhe të përfshijë qytetarët dhe organizatat jofitimprurëse në vendimmarrje.	Në përputhje: Me miratimin e Ligjit Nr. 146/2014 për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, synohet forcimi i hapjes institucionale. Ky ligj kërkon që procesi legjislativ të jetë i hapur dhe të përfshijë qytetarët dhe organizatat jofitimprurëse në vendimmarrje.	Për tu përmirësuar: Një aspekt kritik për Shqipërinë është nevoja për të përfshirë të dhëna të plota dhe në formate të hapura në raportet e dorëzuara parlamentit. Kjo lejon analizën dhe përdorimin e informacionit nga palët e treta, duke siguruar integritetin dhe cilësinë e vendimeve politike të marra mbi bazën e atij informacioni. Implementimi i tij ka hasur në vështirësi, me raporte që theksojnë probleme si mungesa e zbatimit në çdo fazë të procesit dhe ndikimi i kufizuar i konsultimeve në realitet.	https://idmalbania.org/research-report-a-decade-of-public-consultation-laë-in-albania-call-for-reform/
23. Mundësimi i informacionit mbi buxhetin dhe shpenzimet	Parlamenti ka përgjegjësinë të bëjë publik informacion të plotë, të detajuar dhe lehtësisht të kuptueshëm rreth buxhetit kombëtar dhe shpenzimeve publike, duke përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet e kaluara, aktuale dhe të parashikuara. Po ashtu, parlamenti ka detyrën të publikojë informacion rreth buxhetit të vet, duke përfshirë informacion mbi ekzekutimin e tij të buxhetit dhe ofertat e kontratat. Ky informacion do të bëhet publik në tërësi, duke përdorur një taksonomi konsistente, së bashku me përmbledhje, shpjegime ose raporte në një gjuhë të thjeshtë që ndihmojnë në promovimin e kuptimit të qytetarëve.	Në përputhje: hqipëria ka ndërmarrë disa hapa drejt transparencës buxhetore dhe publikimit të shpenzimeve publike. Ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin (Nr. 10296/2010) dhe Ligji për auditimin e brendshëm (Nr. 114/2015) synojnë të sigurojnë transparencën e buxhetit kombëtar.	Në përputhje: hqipëria ka ndërmarrë disa hapa drejt transparencës buxhetore dhe publikimit të shpenzimeve publike. Ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin (Nr. 10296/2010) dhe Ligji për auditimin e brendshëm (Nr. 114/2015) synojnë të sigurojnë transparencën e buxhetit kombëtar.	Për tu përmirësuar: fidat mbeten në nivelin e zbatimit të plotë të tyre. Institucionet publike shqiptare publikojnë të dhëna buxhetore dhe të shpenzimeve, përfshirë buxhetin e tyre vjetor dhe raportet financiare. niveli i detajimit dhe qartësisë së informacionit për qytetarët mbetet i kufizuar. Platforma si Open Data Albania dhe Ministria e Financave publikojnë të dhëna në formate të hapura, por shpesh herë mungon një përmbledhje e thjeshtuar që qytetarët ta kuptojnë lehtësisht informacionin mbi shpenzimet publike dhe alokimin e fondeve. Raportet e auditimeve nga Kontrolli i Lartë i Shtetit shpesh përfshijnë auditime mbi shpenzimet dhe janë të disponueshme publikisht, megjithëse jo gjithmonë përfshihen të dhënat më të fundit ose ato janë të thjeshtuara për publikun e gjerë	Ligji Nr. 10296/2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin Ligji Nr. 114/2015 për auditimin e brendshëm

<p>24. Deklarimi i pasurive dhe garantimi i integritetit të anëtarëve</p>	<p>Parlamenti do të bëjë të disponueshëm informacion të mjaftueshëm për të lejuar qytetarët të formojnë gjykime të informuara në lidhje me integritetin dhe ndershmërinë e anëtarëve, duke përfshirë informacion mbi deklaratat e pasurisë të anëtarëve, shpenzimet e tyre parlamentare dhe të ardhurat e tyre jo-parlamentare, duke përfshirë interesa, dividende, pagesa qiraje ose përfitime të tjera në natyrë.</p>	<p>Në përputhje: Shqipëria ka kuadrin ligjor që kërkon që zyrtarët publikë, përfshirë deputetët, të deklarojnë pasuritë e tyre financiare, interesat biznesore dhe çdo konflikt të mundshëm interesi, në përputhje me standardet ndërkombëtare për transparencë.</p>	<p>Për tu përmirësuar: Qytetarët duhet të kenë në dispozicion mjaftueshëm të dhëna për të vlerësuar integritetin e anëtarëve të veçantë, përfshirë pasuritë e tyre, shpenzimet parlamentare dhe të ardhurat jashtë parlamentit (p.sh., dividendët, qiratë). Sipas praktikave ndërkombëtare, si në Kanada, Indi dhe Afrikën e Jugut, ligjvënësit duhet të deklarojnë jo vetëm pasuritë e tyre, por edhe ato të familjarëve të ngushtë për të shmangur shfrytëzimin e boshllëqeve ligjore. Koreja e Jugut, për shembull, kërkon deklarin e pronave të prekshme dhe të paprekshme të deputetëve, të cilat publikohen për llogari të llogaridhënies më të madhe.</p>	
<p>25. Deklarimi i informacionit mbi veprimtarinë jo etike dhe konfliktet e mundshme të interesave.</p>	<p>Parlamenti do të miratojë rregulla të qarta për të siguruar shpërndarjen e informacionit të nevojshëm për të mbrojtur kundër konflikteve të interesit të vërteta ose të perceptuara dhe shkeljeve etike, duke përfshirë informacionin përkatës mbi ndërveprimet e anëtarëve me lobistët dhe grupet e presionit. Parlamenti do të bëjë gjithashtu publik informacionin mbi rezultatet përfundimtare të çdo hetimi gjyqësor ose parlamentar në lidhje me akuzat për sjellje të papërgjegjshme, konflikte interesi ose korrupsion.</p>	<p>Në përputhje: Shqipëria ka bërë përparime të dukshme në përmirësimin e transparencës dhe përgjegjshmërisë brenda sistemit të saj parlamentar, veçanërisht lidhur me konfliktet e interesit dhe sjelljen e paetik. Një zhvillim i rëndësishëm është Sistemi Elektronik për Deklarimin e Pasurive dhe Konfliktet të Interesit, i cili ka për qëllim të përmirësojë monitorimin dhe verifikimin e deklaratave të pasurive nga zyrtarët publikë dhe përfaqësuesit e zgjedhur. Gjithashtu, Shqipëria ka përmbushur nëntë nga dhjetë rekomandimet e Grupit të Shteteve Kundër Korrupsionit (GRECO), duke theksuar përmirësimet në kodin e sjelljes për parlamentarët dhe mekanizmat e vendosur për deklarin e konfliktet të interesit.</p>	<p>Për tu përmirësuar: Shqipëria nuk ka implementuar një mekanizëm të tillë që do të sigurojë transparencën në marrëdhëniet ndërmjet parlamentarëve dhe grupeve të interesit, duke e bërë më të vështirë mbikëqyrjen e këtyre marrëdhënieve. Edhe pse ekzistojnë rregulla për të raportuar sjelljen e paetik dhe konfliktet e interesit, shpesh mungon publikimi i rezultateve të hetimeve lidhur me këto çështje. Kjo krijon dyshime mbi integritetin e zyrtarëve dhe ngre shqetësime për transparencën e procesit. Ka vonesa në miratimin e ligjeve që rregullojnë transparencën dhe përgjegjshmërinë. Kjo ngadalësim ndikon negativisht në përmirësimin e situatës dhe integrimin e plotë të</p>	<p>https://www.coe.int/en/ëeb/tirana/-/electronic-system-of-declaration-of-assets-and-conflict-of-interests-preventing-corruption-through-increased-transparency-of-assets https://exit.al/en/albania-satisfies-nine-out-of-ten-greco-recommendations/</p>

				standardeve ndërkombëtare në fushën e etikës dhe transparencës.	
	26. Mundësimi i aksesit mbi informacionin historik	Informacioni parlamentar për seancat e mëparshme do të digjitalizohet dhe do të bëhet i disponueshëm për qytetarët për gjithmonë, për rishfrytëzim pa kufizime ligjore ose tarifa. Nëse një parlament nuk mund të digjitalizojë dhe të bëjë të disponueshëm informacionin e tij, ai do të punojë me organizata të jashtme për të lehtësuar shpërndarjen publike të informacionit parlamentar pa kufizime. Parlamenti do të sigurojë akses publik në një bibliotekë parlamentare për të lejuar anëtarët dhe publikun të kenë akses në informacionin historik parlamentar.	Në përputhje: Shqipëria ka bërë disa përpjekje për të ofruar akses në informacionin historik parlamentar, por ka ende sfida dhe probleme të dukshme në këtë drejtim. Si psh: Digjitalizimi i informacionit parlamentar.	Për tu përmirësuar: Mungesa e një biblioteke parlamentare të aksesueshme për publikun. Akoma nuk ka një sistem të plotë dhe të mirëpërcaktuar që garanton aksesin e vazhdueshëm për qytetarët.	
Lehtësimi i aksesit të informacionit parlamentar	27. Mundësimi i disa kanaleve për të aksesuar informacionin .	Parlamenti do të sigurojë akses në informacionin mbi punën e tij përmes kanaleve të shumta; mediat print, transmetimet radio dhe televizione, Internetit dhe teknologjinë e pajisjeve mobile.	Në përputhje: Platforma online, pra faqja e ëeb është një mënyrë.	Për tu përmirësuar: Mungesa e kanaleve të diversifikuara: Edhe pse ka disa përpjekje për të komunikuar informacionin parlamentar përmes mediave tradicionale dhe platformave dixhitale, qasja e informacionit është akoma e kufizuar. Në zonat rurale, ku shpesh ka mungesë të internetit dhe burimeve të shkruara, informacioni parlamentar mund të mos arrijë në mënyrën më efektive, duke bërë që radio dhe televizioni të jenë kanale të rëndësishme për të transmetuar informacionin . Informacioni në formate të ndryshme: Ka një nevojë për të ofruar informacionin në formate të ndryshme që përputhen me nevojat e qytetarëve. Mungesa e formatit dhe kanaleve të ndryshme bën që qytetarët të kenë vështirësi në aksesimin	

				e informacionit që ata kërkojnë, përfshirë historikun e votimeve të deputetëve, që është një aspekt thelbësor i transparencës parlamentare . Disa vende si Zelanda e Re dhe Mbretëria e Bashkuar kanë zhvilluar sisteme të avancuara që ofrojnë informacion të qartë dhe të arritshëm për veprimet parlamentare	
28. sigurimi i aksesit fizik	Parlamenti dhe seancat e tij plenare do të jenë fizikisht të aksesueshme dhe të hapura për të gjithë qytetarët, duke u nënshtruar vetëm kufizimeve të demonstrueshme të sigurisë publike dhe hapësirës.	Në përputhje: Shqipëria ka bërë përpjekje për të siguruar aksesin fizik të qytetarëve në seancat plenare, duke lejuar qytetarët dhe mediat të ndjekin punën që bëhet. Kjo është një shenjë e rëndësishme e transparencës dhe angazhimit demokratik.	Për tu përmirësuar: Ndërsa ka një përpjekje për të siguruar aksesin fizik për qytetarët, ekzistojnë ende barrierat që ndalojnë një pjesë të konsiderueshme të popullsisë për të ndjekur ngjarjet në parlament. Këto barrierat mund të përfshijnë kufizime të hapësirës dhe çështje të sigurisë publike. Mungesa e një galerie publike të mirëpërcaktuar dhe të qartë mund të dërgojë mesazhin se ndjekja e punimeve parlamentare nuk është e mirëpritur. Siguria dhe kufizimet: Edhe pse janë të rëndësishme masat e sigurisë për të mbrojtur parlamentarët dhe punonjësit publikë, ndalimi i qytetarëve të vëzhgojnë punimet mund të sjellë një ndjenjë që ata janë të papërshtatshëm. Ajo që është e rëndësishme është që kufizimet të jenë të përcaktuara qartë, të publikohen dhe të jenë të padiskriminueshme. Vendet si Afrika e Jugut kanë përfshirë aksesin publik në Kushtetutën e tyre, duke bërë që aksesin fizik të jetë një standard i rëndësishëm për transparencën parlamentare. Në Shqipëri, ka një nevojë për përmirësime në këtë aspekt, për të siguruar që të gjithë qytetarët të kenë mundësi të	https://www.ipu.org/World-e-parliament-Report-2010	

				ndjekin veprimtaritë parlamentare dhe të kontribuojnë në procesin demokratik.	
29. Garantimi i aksesit nga ana e medias	Parlamenti do të sigurojë që mediat dhe vëzhguesit e pavarur të kenë akses të plotë në procedurat parlamentare; kriteret dhe procesi për dhënien e aksesit mediave do të përcaktohen qartë dhe do të jenë të disponueshme publikisht.	Në përputhje: Akses i garantuar: Parlamenti shqiptar ka bërë përpjekje për të siguruar aksesin e mediave në punimet e tij. Ato kanë të drejtë të ndjekin seancat plenare dhe komitetet, që është një hap pozitiv për transparencën. Regullore dhe Procedura: Ka rregulla që përcaktojnë kriteret dhe procesin e akreditimit për gazetarët.		Për tu përmirësuar: Rregullat dhe kriteret duhet të jenë më të qarta dhe më të aksesueshme për të gjitha palët e interesuara. Disa herë, gazetarët dhe vëzhguesit e pavarur janë përballur me vështirësi në sigurimin e aksesit të plotë, sidomos gjatë ngjarjeve të rëndësishme politike.	
30. Mundësimi i transmetimeve në kohë reale dhe sipas kërkesës	Duhet të bëhen përpjekje për të siguruar qytetarët me akses në arkiva në kohë reale dhe me kërkesë në procedurat parlamentare përmes radios, televizionit dhe Internetit.	Në përputhje: Parlamenti shqiptar ka filluar të ofrojë disa transmetime të drejtpërdrejta të seancave plenare dhe komisioneve, duke lehtësuar aksesin e qytetarëve në punimet parlamentare. Ka iniciativa për të krijuar një arkiv elektronik që lejon shikimin e punimeve në kërkesë, i cili është një hap përpara në drejtim të transparencës dhe aksesit publik.		Për tu përmirësuar: avarësisht përpjekjeve, akoma ka limite në shtrirjen dhe përhapjen e transmetimeve të drejtpërdrejta, dhe shumë qytetarë nuk kanë akses të rregullt në këto shërbime. Infrastrukturat e nevojshme për transmetim dhe arkivim të përmbajtjeve mund të mos jenë të mjaftueshme, duke penguar kështu ofrimin e shërbimeve të plota dhe të qarta. Disa vende kanë zhvilluar platforma të avancuara për të lehtësuar kërkimin dhe shikimin e video përmbajtjeve, gjë që ende mbetet për t'u arritur në Shqipëri.	https://www.coe.int/en/ëeb/portal/home https://www.idea.int/
31. Lehtësimi i aksesit përgjatë shtetit	Në masën e mundur, aksesimi në informacionin parlamentar nuk do të kufizohet nga barrierat gjeografike. Megjithatë, përdorimi i faqeve të internetit të parlamentit lehtëson aksesin në informacionin parlamentar pa kufizime gjeografike; në vendet ku aksesimi dhe përdorimi i internetit janë të kufizuara, parlamenti do të kërkojë	Në përputhje: Qeveria ka bërë përpjekje për të ofruar informacion parlamentar përmes faqes zyrtare të Parlamentit, duke e bërë atë më të lehtë për të aksesuar informacion nga qytetarët në mbarë vendin. Disa institucione kanë implementuar sisteme për të pranuar dhe organizuar mendimet e qytetarëve përmes kanaleve		Për tu përmirësuar: Mungesa e Infrastruktures në Zonat Rural: Ndërsa aksesin online është i dobishëm, shumë qytetarë në zona rurale ndoshta nuk kanë akses të mirë në Internet, gjë që ndikon negativisht në aftësinë e tyre për të marrë informacionin e nevojshëm. Kufizime Financiare: Çështjet financiare dhe infrastrukturale shpesh pengojnë	Këshilli i Evropës Instituti Ndërkombëtar i Demokratëve

		mjete të tjera për të siguruar aksesin publik në informacionin parlamentar në të gjithë vendin.	si SMS, që ndihmojnë në angazhimin e qytetarëve në proceset ligjore.	zbatimin e plotë të strategjive për lehtësimin e aksesit, veçanërisht për ato që kërkojnë investime në teknologji dhe qendra informacioni. Përfshirja e Niveleve të Ndryshme Sociale: Duhet të bëhen përpjekje të mëtejshme për të siguruar që të gjitha grupet sociale, duke përfshirë ata me të ardhura të ulta, të kenë akses të barabartë në informacionin parlamentar dhe në teknologji.	
32. Përdorimi i gjuhës së thjeshtë	Parlamenti duhet të sigurojë që gjuha ligjore ose teknike të mos shërbejë si një barrierë për qytetarët që kërkojnë të aksesojnë informacionin parlamentar. Ndërsa njihet nevoja për të përdorur një gjuhë të saktë në shkrimin e ligjeve, parlamenti ka detyrimin të zhvillojë përmbledhje në gjuhë të thjeshtë dhe mjete të ngjashme për ta bërë informacionin parlamentar të aksesueshëm dhe të kuptueshëm për anëtarët dhe qytetarët me formim dhe ekspertizë të ndryshme.	Në përputhje: . Disa institucione kanë filluar të publikojnë përmbledhje dhe informacione në gjuhë të thjeshtë, të cilat janë më të lehta për t'u kuptuar nga ata që nuk kanë një formim juridik. Kjo është e rëndësishme për të inkurajuar pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset demokratike. Shqipëria ka zhvilluar disa iniciativa për të përmirësuar komunikimin e saj me qytetarët, duke përfshirë përdorimin e platformave digjitale për të lehtësuar qasjen në informacionin parlamentar. Kjo përfshin krijimin e portaleve online që ofrojnë informacion të thjeshtëzuar për legjislacionin dhe procedurat parlamentare. Organizatat joqeveritare, si "Instituti i Politikave Publike" dhe "Qendra për Kërkimin dhe Zhvillimin e Politikave", kanë luajtur një rol aktiv në promovimin e transparencës dhe qasjes në informacionin parlamentar, duke kërkuar që qeveria të përdorë gjuhë më të thjeshtë dhe më të kuptueshme për legjislacionin.	Për tu përmirësuar: Mungesa e Burimeve: Edhe pse ka përpjekje për të krijuar materiale të thjeshta, shpesh herë mungojnë burimet e nevojshme për të zhvilluar këto materiale në mënyrë sistematike. Kjo mund të kufizojë mundësitë për të arritur një publik më të gjerë. Ndërgjegjësimi i Qytetarëve: Shumë qytetarë nuk janë të vetëdijshëm për këto nisma dhe për mënyrat si mund të aksesojnë informacionin e nevojshëm. Kjo kërkon fushata informuese për të rritur njohuritë mbi përmbajtjen dhe mënyrat e aksesit në informacionin parlamentar.		

	<p>33. Përdorimi i disa Gjuhëve Kombëtare ose të Punes</p>	<p>Kur Kushtetuta ose rregullat parlamentare parashikojnë përdorimin e shumë gjuhëve kombëtare ose pune në parlament, parlamenti do të bëjë çdo përpjekje të arsyeshme për të siguruar interpretimin e menjëhershëm të seancave dhe përkthimin e shpejtë të regjistrit parlamentar.</p>	<p>Në përputhje: Kushtetuta shqiptare parashikon përdorimin e gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare, por ka njohje të gjuhëve të tjera, siç është gjuha e komuniteteve të ndryshme etnike në vend. Kjo është një bazë e rëndësishme për përfshirjen e gjuhëve të shumta në praktikën parlamentare. Kuvendi shqiptar ka bërë disa përpjekje për të përfshirë përkthime dhe interpretim të proceseve parlamentare për përfaqësuesit e komuniteteve të ndryshme</p>	<p>Për tu përmirësuar: Një nga sfidat kryesore është mungesa e interpretimit të menjëhershëm për procedurat parlamentare. Kjo do të ndihmonte shumë në përfshirjen e qytetarëve që flasin gjuhë të tjera, duke eliminuar diskriminimin në informacionin e ofruar. Sipas raporteve, shumica e informacionit parlamentar është në gjuhën shqipe, dhe përkthimet në gjuhë të tjera janë të pakta. Kjo krijon një barrierë për qytetarët që flasin gjuhë të tjera dhe ndikon negativisht në pjesëmarrjen e tyre në proceset demokratike. Pavarësisht përpjekjeve për të përfshirë qytetarët e komuniteteve të ndryshme, shumë nga ta ndihen të përjashtuar nga procesi parlamentar për shkak të barrierave gjuhësore.</p>	
	<p>34. Sigurimi i aksesit të lirë</p>	<p>Informacioni parlamentar do të jetë në dispozicion për qytetarët për qasje të pakufizuar, ripërdorim dhe ndarje pa pagesë</p>	<p>Në përputhje: Informacioni mbi projektligjet, ligjet e miratuara dhe diskutimet parlamentare është i disponueshëm në faqen zyrtare të internetit, duke përfshirë gjithashtu dhe rezultatet e votimeve të deputetëve dhe prezencën e tyre në seanca. Seancat parlamentare transmetohen drejtpërdrejt në televizion, çfarë përmirëson transparencën publike.</p>	<p>Për tu përmirësuar: disa fusha ende mbeten problematike, veçanërisht lidhur me qasjen e publikut në informacionin mbi buxhetin e shtetit, detajet e prokurimeve publike dhe strukturën organizative të Kuvendit, ku ky institucion ka performancë të ulët. Për më tepër, ndërsa ligji për konsultimin publik ekziston, ka mungesë qartësie mbi mënyrën se si rekomandimet e publikut ndikojnë në procesin legjislativ, çfarë tregon se mekanizmat e hapjes dhe transparencës nuk janë zbatuar ende në mënyrë të plotë dhe efektive.</p>	<p>https://www.mjaft.org/sites/default/files/Openness%20of%20Parliament%20in%20the%20region%20and%20Albania.pdf</p>
<p>Mundësim elektronik</p>	<p>35. Mundësimi i informacionit në</p>	<p>Informacioni parlamentar do të përgatitet dhe publikohet në një format transparent dhe të strukturuar, si p.sh. XML i strukturuar, që mund të lexohen</p>	<p>Në përputhje: Parlamenti Shqiptar ka përmirësime në lidhje me transparencën e informacionit parlamentar. Ka një përmbushje prej 73%</p>	<p>Për tu përmirësuar: Parlamenti Shqiptar ende nuk plotëson plotësisht kërkesën për përdorimin e formateve të strukturuar dhe të hapura, si XML. Portali i të dhënave të hapura i</p>	<p>https://opendata.gov.al/ https://www.mjaft.org/sites/default/files/Parliament%20Openness Albania.pdf</p>

	struktura të transparent e dhe të strukturuar a	dhe përpunohen nga kompjuterët, në mënyrë që informacioni parlamentar të mund të ripërdoret dhe analizohet lehtësisht nga qytetarët, shoqëria civile, sektori privat dhe qeveria.	e treguesve për matjen e transparencës institucionale nga ana e parlamentit.	Shqipërisë (OpenData) ofron të dhëna nga institucione të ndryshme, përfshirë Parlamentin, por shumë prej tyre nuk janë ende në formate të përpunueshme lehtësisht nga softuerët, siç janë formatet XML. Informacioni i paraqitur është shpesh në formate më të thjeshta si PDF ose tabela, të cilat kërkojnë përpunim shtesë për t'u ripërdorur ose analizuar në mënyrë efektive nga palët e interesuara si qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile.	
36. Sigurimi i përdorshmërisë së teknologjisë	Parlamenti do të sigurojë përdorshmërinë teknologjike të informacionit parlamentar duke ofruar udhëzime të qarta për përdorimin e çdo baze të të dhënave online ose mjetesh që i mundësojnë qytetarëve të ripërdorin informacionin parlamentar nga faqja e internetit të parlamentit. Në masën që parlamenti ofron një ndërfaqe përdoruesi, ai do të përdorë praktikën më të mirë për të përmirësuar përdorshmërinë e saj.	Në përputhje: Sipas raporteve të fundit, ka përmirësime në ofrimin e qasjes në të dhëna për qytetarët përmes faqeve të zyrta.		Për tu përmirësuar: Aksesi nuk është ende plotësisht i thjeshtë dhe i strukturuar për përdoruesit pa njohuri teknologjike të thelluara. Portali zyrtar i Parlamentit ofron një sërë dokumentesh dhe informacionesh për qytetarët, por disa nga sfidat kryesore janë mungesa e udhëzimeve të qarta për përdorimin e bazave të të dhënave dhe mjeteve online. Qytetarët shpesh mund të kenë vështirësi për të gjetur ose përdorur informacionin në formate të lehta për t'u kuptuar dhe orientuar, veçanërisht në mungesë të një ndërfaqeje më të përshtatshme dhe të aksesueshme. Në krahasim me praktikën më të mirë ndërkombëtare, të tilla si përdorimi i standardeve E3C për aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara dhe përmirësimin e dizajnit të faqeve për një përdorueshmëri më të lehtë, Shqipëria ende nuk i ka zbatuar plotësisht këto standarde. Implementimi i funksioneve të ndihmës, pyetjeve të shpeshta, dhe kontakteve për mbështetje teknike janë aspekte që duhet të përmirësohen për t'u	https://opendata.gov.al/ https://www.mjft.org/sites/default/files/Parliament%20Openness Albania.pdf

				ofruar qytetarëve akses më të lehtë dhe pa diskriminim teknologjik.	
37. Mbrojtja e privatësisë së qytetarëve	Faqet e internetit të parlamentit do të kenë një politikë të qartë dhe të shkurtër për privatësinë për t'i informuar qytetarët se si po përdoren të dhënat e tyre personale. Parlamenti nuk do të përdorë kërkesa për anëtarësim ose regjistrim që kufizojnë qasjen publike në informacionin në faqet e internetit të parlamentit ose lejojnë gjurmimin e informacionit personal të identifikueshëm pa pëlqim të shprehur qartësisht.	Në përputhje: Shqipëria ka miratuar ligje dhe rregullore që mbrojnë të dhënat personale, përfshirë Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili është harmonizuar me standardet e BE-së për këtë çështje. Këto ligje ndihmojnë në forcimin e mbrojtjes së privatësisë së qytetarëve.	Për tu përmirësuar: Shumë faqe zyrtare shqiptare nuk kanë një politikë të qartë dhe të lehtë për t'u kuptuar për mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve që i vizitojnë. Në shumë raste, faqet e institucioneve qeveritare në Shqipëri kërkojnë regjistrim ose informacione identifikuese për të pasur qasje në informacione të caktuara. Kjo bie në kundërshtim me parimin e aksesit të hapur dhe jo-diskriminues ndaj informacionit parlamentar. Nuk ka një qartësi të mjaftueshme për mënyrën se si mbledhen dhe përdoren të dhënat e përdoruesve, dhe qytetarët shpesh nuk kanë dijeni për përpunimin e këtyre të dhënave. Sipas Sunlight Foundation, qasja pa diskriminim ndaj të dhënave nënkupton që qytetarët duhet të kenë akses pa u kërkuar identifikim apo justifikim për përdorimin e tyre.	https://sunlightfoundation.com/ https://opendata.gov.al/	
38. Përdorimi i formateve të hapura dhe softëare-ve me burim të hapur	Parlamenti do t'i japë përparësi publikimit të informacionit digjital në formate jo-private dhe të hapura, si dhe përdorimit të aplikacioneve softuerike falas dhe me burime të hapura.	Në përputhje:	Për tu përmirësuar: Shumë nga dokumentet dhe të dhënat publike ende lëshohen në formate të pronarit, si PDF ose formate të tjera që janë të lidhura me softëare të caktuar, si Microsoft Office. Kjo pengon aksesin dhe ri-përdorimin e informacionit nga qytetarët, duke e bërë më të vështirë përdorimin e tyre për qëllime të tjera, si hulumtimi ose analiza.	https://www.govloop.com/community/blog/open-formats-and-open-source-for-better-government/	
39. Lejimi i shkarkimit	Informacioni parlamentar duhet të jetë i shkarkueshëm lehtësisht, në grup dhe në formate të	Në përputhje: Parlamenti shqiptar ofron informacionin në faqen e tij zyrtare.	Për tu përmirësuar. Shumica e dokumenteve janë të disponueshme vetëm në format PDF, që nuk janë		

	për ripërdorim	dokumentuara mirë për të lejuar ripërdorimin e lehtë të informacionit.		gjithmonë të lehta për t'u riintegruar dhe analizuar. Ka pasur përpjekje për të ofruar disa dokumente në formate më të hapura, por kjo nuk është ende një praktikë e zakonshme. Shumica e informacionit mbetet e kufizuar në forma që nuk lejojnë manipulimin e lehtë të të dhënave. Aktualisht, Parlamenti shqiptar nuk ofron një mundësi të qartë për shkarkimin në grup të dokumenteve. Informacioni zakonisht duhet të merret dokument për dokument, që e bën procesin më të ngadalshëm dhe më të vështirë për ata që duan të analizojnë të dhënat në masë. Sipas raportit të Botës për e-Parlamentin dhe studimeve të tjera, Shqipëria duhet të përmirësojë mënyrën se si ofron informacionin parlamentar, duke u përputhur më mirë me praktikën më të mira globale. Kjo do të ndihmonte në rritjen e angazhimit qytetar dhe do të lehtësonte analizat e informacionit.	
	40. Mirëmbajtja e ëbfaqeve parlamentare	Edhe në vendet me përdorim të kufizuar të internetit, mbajtja dhe përditësimi i rregullt i një faqeje parlamentare gjithëpërfshirëse është një aspekt i rëndësishëm i hapjes parlamentare në botën moderne dhe të lidhur. Parlamenti duhet të sigurojë që informacioni parlamentar të jetë në dispozicion në format elektronik dhe të konsiderojë shpërndarjen online si një mjet të domosdoshëm komunikimi	Në përputhje:	Për tu përmirësuar: Nuk ka shumë informacione publike që tregojnë nëse Parlamenti përdor metadata në mënyrë efektive për të lehtësuar kërkimin e informacionit. Kjo është një fushë që mund të ketë nevojë për përmirësim. Gjithashtu ka shumë raste ku sistemi e-albania nuk punon sic duhet ose bllokohet, ndoshta nga mbingarkesa.	
	41. Përdorimi i mekanizma	Parlamenti duhet ta bëjë sa më të lehtë për qytetarët të gjejnë shpejt informacionin parlamentar të	Në përputhje:	Për tu përmirësuar:	41. Përdorimi i mekanizmave të thjeshtë dhe të qëndrueshëm

ve të thjeshtë dhe të qëndrueshëm	dëshiruar, duke krijuar databaza që mundësojnë kërkime të thjeshta dhe të komplikua përmes përdorimit të metadatat e përshtatshme. Informacioni duhet të jetë i disponueshëm në një vend që mbetet i përhershëm, për shembull, në një faqe interneti me një URL të qëndrueshme.			<p>Parlamenti shqiptar duhet të krijojë baza të dhënash që lejojnë kërkimin e thjeshtë dhe të avancuar të informacionit parlamentar. Kjo do të thotë që informacioni duhet të jetë i organizuar në mënyrë të tillë që qytetarët të mund ta gjejnë lehtësisht atë që po kërkojnë, përfshirë dokumente, ligje dhe aktivitete parlamentare.</p> <p>Përdorimi i metadata është një faktor i rëndësishëm në lehtësimin e kërkimeve. Metadata ndihmon në klasifikimin dhe përshkrimin e dokumenteve, duke e bërë më të lehtë për qytetarët të gjejnë informacionin e nevojshëm. Parlamenti duhet të adoptojë standarde të miratuara për metadata që do të ndihmojnë në rritjen e efikasitetit të kërkimit.</p> <p>Është thelbësore që informacioni të jetë i disponueshëm në URL të qëndrueshme, që do të thotë se lidhjet e dokumenteve nuk duhet të ndryshojnë me kalimin e kohës.</p> <p>Mjetet si Akoma Ntoso dhe Bungeni mund të ofrojnë një kornizë për standardizimin e metadata dhe informacionit ligjor. Këto mjete ndihmojnë në lehtësimin e ndërveprueshmërisë semantike të dokumenteve, duke e bërë më të lehtë për përdoruesit të kuptojnë marrëdhëniet ndërmjet dokumenteve të ndryshme.</p>	
42. Grupimi i informacioneve të lidhura	"Parlamenti duhet të përpiqet të përmirësojë aftësinë e qytetarëve për të gjetur informacionin parlamentar të rëndësishëm duke lidhur informacionin parlamentar me informacione të tjera të lidhura,	Në përputhje:		Për tu përmirësuar? Disa parlamente përdorin standarde si RDF për të lidhur dokumentet. Nëse Parlamenti shqiptar përdor standarde të tilla, do të lehtësonte procesin e lidhjes së informacionit dhe do të ndihmonte në	

	për shembull, duke lidhur referencat në historinë e një projekti ligjor me versionet e mëparshme të legjislacionit, me raportet përkatëse të komisioneve, me dëshmitë e ekspertëve, me ndryshimet e sponsorizuara dhe me pjesët e Hansard që përmbajnë regjistrin e debatit parlamentar mbi atë legjislacion të caktuar.		krijimin e një strukture më të organizuar të informacionit. Disa vende, si Brazili, kanë zhvilluar platforma si LexML për të unifikuar informacionin legjislativ dhe për të lehtësuar aksesin në të. Aktualisht, nuk ka informacion të qartë nëse Shqipëria ka ndonjë platformë të tillë që mundëson lidhjen e informacionit legjislativ.	
43. Mundësimi i përdorimit të shërbimeve të shërbimeve të alarmit	Kur është e mundur, parlamenti duhet t'u ofrojë qytetarëve mundësinë për t'u abonuar në shërbime që i njoftojnë ata për kategori të caktuara të veprimeve parlamentare përmes përdorimit të emailit, mesazheve SMS ose teknologjive të tjera.	Në përputhje: Aktualisht, Parlamenti shqiptar ofron shërbime të njoftimit përmes sistemit të tij të uebit, ku qytetarët mund të informohen për aktivitete dhe ndryshime të rëndësishme, siç janë ligjet dhe aktivitetet e komisioneve.	Për tu përmirësuar: Megjithatë, informacioni për regjistrimin në shërbime njoftimi përmes emailit ose SMS nuk është aq i përhapur. Në disa raste, informacioni mund të jetë në formë të përgjithshme dhe jo në mënyrë të personalizuar për secilin qytetar. Sipas Raportit të Botës për Parlamentin 2010, rreth 47% e parlamenteve ofrojnë një formë të shërbimit të njoftimit. Në Shqipëri, nuk ka një sistem të konsoliduar që të ofrojë njoftime automatike për qytetarët për ngjarje të rëndësishme.	https://www.ipu.org/
44. Lehtësimi i komunikimit të dyanshëm	Parlamenti duhet të përpiqet të përdorë mjete teknologjike ndërvepruese për të nxitur aftësinë e qytetarëve që të japin kontribut të rëndësishëm mbi legjislacionin dhe aktivitetin parlamentar, si dhe për të lehtësuar komunikimin me anëtarët ose stafin parlamentar.	Në përputhje: Parlamenti shqiptar ka bërë përpjekje për të angazhuar qytetarët përmes faqes së tij zyrtare dhe platformave të mediave sociale.	Për tu përmirësuar: niveli i ndërveprueshmërisë dhe mekanizmat e reagimit të disponueshëm për qytetarët mbetet i kufizuar. Aktualisht, nuk ka një sistem të vendosur që lejon qytetarët të ofrojnë reagime në kohë reale ose të angazhohen në diskutime mbi projektligjet përmes një forumi publik, siç shihet në parlamentet e tjera globale. Ndërsa Parlamenti shqiptar ka një prani në mediat sociale, si Facebook dhe Tëitter, angazhimi shpesh është më shumë i orientuar në transmetimin e informacionit sesa në lehtësimin e	

				<p>dialogut ose mbledhjen e inpueteve nga qytetarët.</p> <p>Sipas Raportit të Botës mbi Parlamentin 2010, ndërsa 88% e parlamenteve ofrojnë informacion kontaktues publik me email, vetëm 18% përdorin grupe diskutimi online për veprimet legjislative. Ky trend është reflektiv i situatës në Shqipëri, ku fokusi është më shumë në ofrimin e informacionit sesa në inkurajimin e pjesëmarrjes aktive</p>	
--	--	--	--	---	--

REFERENCA

- Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim. Projekte të Bashkëpunimit Ndërkombëtar në Shqipëri. Marrë nga <https://www.eda.admin.ch/countries/albania/en/home/international-cooperation/projects.html>
- Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim. Projekte të Bashkëpunimit Ndërkombëtar në Shqipëri: Faza 2. Marrë nga <https://www.eda.admin.ch/countries/albania/en/home/international-cooperation/projects.html/content/dezaprojects/SDC/en/2017/7F09576/phase2.html?oldPagePath=>
- BIRN Albania. Marrë nga <https://birn.eu.com/network/birn-albania/>
- Deklarata për Parlamentin e Hapur. Marrë nga <https://openingparliament.org/declaration/>
- Exit.al. (2024). Shqipëria plotëson nëntë nga dhjetë rekomandimet e GRECO-s. Marrë nga <https://exit.al/en/albania-satisfies-nine-out-of-ten-greco-recommendations/>
- Freedom House. (2024). Raporti i Freedom House: Demokracia në Shqipëri, pa përmirësim. Marrë nga <https://citizens.al/en/2024/04/11/the-report-of-freedom-house-democracy-in-Albania-no-improvement/>
- Institute for Democracy and Mediation. (2024). Raporti mbi pjesëmarrjen e OSHC-ve në vendimmarrje në Shqipëri. Marrë nga <https://idmalbania.org/report-cso-participation-in-decision-making-in-albania/>
- Institute for Democracy and Mediation. (2024). Raporti i kërkimit: Një dekadë e ligjit të konsultimeve publike në Shqipëri: Thirrje për reformë. Marrë nga <https://idmalbania.org/research-report-a-decade-of-public-consultation-law-in-albania-call-for-reform/>
- National Democratic Institute. (2020). Anketa mbi Angazhimin Politik në Shqipëri 2020. Marrë nga <https://www.ndi.org/sites/default/files/Albania%20Political%20Engagement%20Survey%202020%20English.pdf>
- National Democratic Institute. (2020). Përmbledhje e burimeve dhe ekspertizës në dispozicion për Anëtarët e Parlamentit. Marrë nga <https://www.ndi.org/sites/default/files/Overview%20of%20Resources%20and%20Expertise%20available%20to%20Members%20of%20Parliament.pdf>
- Office of the High Commissioner for Human Rights. (n.d.). Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Marrë nga <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/international-covenant-civil-and-political-rights>
- Kuvendi i Shqipërisë. Deklarata për Transparencë. Marrë nga <https://kuvendiefiles.blob.core.windows.net/webfiles/DeklarateTransparence.pdf>
- Ligji Nr. 10296/2010 i ndryshuar, për menaxhimin financiar dhe kontrollin.
- Ligji Nr. 114/2015 i ndryshuar, për auditimin e brendshëm në sektorin publik.
- Ligji Nr. 119/2014 i ndryshuar, "Për të drejtën e informimit".
- Ligji Nr. 146/2014, "Për njoftimin dhe konsultimin publik".
- MJAFT! (2019). Openness of Parliament in Albania. Marrë nga https://www.mjaft.org/sites/default/files/Parliament%20Openness_Albania.pdf
- Open Data Albania. Marrë nga <https://opendata.al/>
- Open Government Partnership. (2021). Fact Sheet për Parlamentet e Hapura. Marrë nga <https://www.opengovpartnership.org/wp-content/uploads/2021/11/Open-Parliaments-Fact-Sheet.pdf>
- Open Government Partnership. (2023). Plani i Veprimit për Shqipërinë 2023-2025. Marrë nga https://www.opengovpartnership.org/wp-content/uploads/2023/04/Albania_Action-Plan_2023-2025_EN.pdf

- Open Government Partnership. (2024). Rishikimi i Planit të Veprimit për Shqipërinë 2023-2025. Marrë nga https://www.opengovpartnership.org/wp-content/uploads/2024/02/Albania_Action-Plan-Review_2023-2025_EN.pdf
- Partners Albania. (2024). Pjesëmarrja e shoqërisë civile dhe qytetarëve në vendimmarrje. Marrë nga <https://www.partnersalbania.org/publication/participation-of-civil-society-and-citizens-in-decision-making/>
- Platforma e Konsultimit Publik në Shqipëri. Marrë nga <https://www.konsultimipublik.gov.al>
- Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë. Marrë nga <https://www.parlament.al/Kuvendi/Rregullorja>
- Sunlight Foundation. Marrë nga <https://sunlightfoundation.com/>
- United Nations. (1948). Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut. Marrë nga <https://www.un.org/en/about-us/universal-declaration-of-human-rights>
- World e-Parliament Report 2010. Marrë nga <https://publicadministration.desa.un.org/publications/world-e-parliament-report-2010>